

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7693 E hënë 29 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
Jemi në vitin 2018 dhe Shqipëria ka një dekadë që është futur në NATO, të gjithë e ëndërronim këtë ditë, të majtë dhe të djathtë si muslimanë dhe krishterë. Forcat e ...
Vijon në faqen 20

Nga FISNIK ZIÇISHTI
Pse po i stërvit shteti!!!


Opinion **Ditës**
Ditët që do të vijnë do të sjellin të tjera surpriza në politikën e vendit. Është e kuptueshme, kur në një vend varfëria dhe krimi janë ulur këmbëkryq, pritet...
Vijon në faqen 21

Nga SULEJMAN MATO
Sinoptika politike: Parashikohet një dimër opozitar me shira dhe breshër të përkohshëm



Lista e plotë me emrat e ish-të përndjekurve


Dëmshpërblehen 1700 ish-të burgosur politikë, procedura që duhet të ndjekin

Ministria e Financave: Dokumentet që ju duhen për të përfutur këstin e radhës
Ministria e Financave dhe Ekonomisë informon se ka filluar procedurën e pagesës së kështit të tretë për kategorinë e subjekteve përfutuese joparësore. Për trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që bëjnë pjesë në kategorinë joparësore, dokumentet që duhet të dërgojnë janë: Dëshmi trashëgimie ligjore për të dënuarin politik, origjinale ose kopje e njëzuar noterizuar...
Në faqet 8-9

DETAJET E NGJARJES NE BULARAT, KUSH ISHTE 35-VJEÇARI DHE QENDRIMET E TIJ

PLUMBA POLICISE, RENE VRET EKSTREMISTIN GREK

Vrasja e Konstandinos Kaçifa, Athina: E papranueshme. Rama: Marrëzi. Të dashur fqinj, bashkohuni me ne. Protesta para ambasadës shqiptare në Greqi



(Në foto) Ekstremisti grek Konstandinos Kaçifa. Plumba mbi makinën e policisë

XHAFAJ TË DIELEN NË PUNË
Sandër Lleshi në pikëpyetje? Dyshime për rolin e tij në ngjarjen e 21 janarit
Në faqen 6

NDERMJETESI
Malaj: Bllokohen lejet e qëndrimit për mijëra emigrantë në Greqi, kërkesa
Në faqen 7

KESHILLA NGA YLLI MERJA
Arben Rugia: 39% e grave në Shqipëri i nënshtrohen lindjeve me operacion, faktorët
Suplement

SOT LUHET KRYEDESHJA
Partizani-Skënderbeu, trajneri Shehi: Shkojmë për të fituar, nuk kemi presion
Në faqen 22

ISH-MINISTRJA: EMRI I KRYEMINISTRIT TË RI



INTERVISTA
Zgjedhje para kohe, Gjoshja: Xhafaj iku, tani radha e Ramës. Nuk do ta falim
Në faqet 4-5

Si e argumentonte oficeri i Kufirit, moslejimin e "Shën Tereza dhe djajtë"

Kur Koço Danaj detyroi Enverin të ndalonte filmin italian

Zbulohet korrespondenca e vitit 1974 e sekretarit të Enverit, Haxhi Kroi

Nga DASHNOR KALOÇI
Brez i shqiptarëve që kanë qenë në moshë të rritur në fillimin e viteve '70-të e kujtojnë fare mirë se si thyeshin sportelet e biletave dhe dyert e kinemave në mbarë vendin kur shfaqeshin filma të huaj, si p.sh. ato të regjisorit të fam-



EKSKLUZIVE

shëm italian, Damiano Damiani, "Gruaja më e bukur" (La moglie più bella) të interpretuar nga aktorja Ornella Muti, (asokohe 14 vjeçare) në rolin e Franceska Çimarozës dhe Alesio Orano në rolin e Vito Juvares, apo "Rrëfimet e Komisarit të Policisë"...

Në faqet 10-11

EKSTREMISTI GREK REAGIMET

Kush ishte 35-vjeçari dhe detajet minut pas minute të ngjarjes

Luftë për 30 minuta me policinë, vritet Kostandinos Kaçifa

Festa e Greqisë në Bularat, arenë krismash

Më 28 tetor në festën e Greqisë, Bularati i Gjirokastrës ku zhvillohen gjithnjë festime për këtë ditë të shënuar për grekët, u kthye në arenë krismash. Kostandinos Kaçifa, 35 vjeç shtiu në ajër për të festuar ndërkaq me afrimin e policisë, qëlloi dhe mbi makinën e tyre. Thuhet se i riu ishte i divorcuar dhe dyshohet se vuante nga depresioni. I riu u largua në mal për t'i shpëtuar ndjekjes ndërsa mori me vete tre karikatorë. Pas lokalizimit ai nuk iu bind thirrjeve të policisë për dorëzim dhe për 30 minuta ka shtirë ndaj tyre. Gjatë luftës me policinë ai u vra nga policia. Nderkaq në një video të hedhur në internet tregohet se disa banorë të Bularatit e kanë përcjellë me sharje dhe fyerjet të rënda Policinë e Shtetit pas ekzekutimit të të riut ekstremist.



Plumba mbi makinën e policisë

ÇFARË SIMBOLIZON KJO FESTE
28 nëntori quhet ndryshe si festa e Jo-së pasi kryeministri grek Ioanis Metaksa, i tha jo Italisë për të kaluar mes shtetit të tyre me qëllim pushtimin e vendeve të tjera. Kjo "Jo" kishte kosto pasi e futi në luftë Greqinë me Italinë, megjithatë akti i të thënë: "Jo", ishte me vlerë për ta.

Çfarë shkruante Kostandinos Kaçifa në "Facebook", kërcënimet deri në vdekje

Janë të ftuar të gjithë grekët e Vorio-Epirit në 28 tetor të dërgojmë një mesazh për të gjithë... Greqi ose vdekje". Kështu shkruante pak ditë më parë në 'Facebook' Kostandinos Kaçifa, 35-vjeçari, i cili terrorizoi me armë fshatin Bularat në Gjirokastrë, ku pasi qëlloi në ajër, hapi zjarr edhe ndaj policisë. Teksa shfaqet duke pozuar me flamurin e Vorio-Epirit, duket se i riu ka paralajmëruar ngjarjen në fjalë, ndërsa 'kërcënon' me mesazhin. Një tjetër mesazh i



jmëruar ngjarjen në fjalë, ndërsa 'kërcënon' me mesazhin. Një tjetër mesazh i

Kaçifas në 'Facebook' ka të bëjë me politikën, ja si e shihje ai: "Tsipra dhe Rama bëjnë plane pa nikoqirin (pa të zotin e shtëpisë). Për një gjë të jenë të sigurt, rinia e ashpër dhe e zjarrtë e Vorio-Epirit nuk do jetë spektatore. Janë të ftuar të gjithë grekët e Vorio-Epirit në 28 tetor të dërgojmë një mesazh për të gjithë...Greqi ose vdekje ?????", -shkruante Kaçifa.

kundërpërgjigje, të forcave speciale gjatë shkëmbimit të zjarrit ka mbetur i vrarë shtetasi Kostandinos Kaçifa. Në vendngjarje u sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë automatike, model Kallashnikov, dy karikatorë municioni, një çantë me fishkë luftarakë, si dhe 31 gëzhoja. Në banesën e shtetasit Kaçifa u sekuestrua edhe një uniformë kamuflazh. Grupi hetimor në drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë si dhe të Prokurorisë së Krimeve të Rënda po kryejnë veprimet në vendngjarje.

DETAJET
Policia e Shtetit ka dhënë detaje të reja në lidhje me vrasjen e 35-vjeçarit sot pasditë në Bularat të Gjirokastrës: Gjatë ditës së sotme datë 28.10.2018, rreth orës 10.00, në fshatin Bularat të Bashkisë Dropull të Rrethit Gjirokastrë ka pasur të shtëna me armë zjarri. Punonjësit e Policisë, të cilët ishin të planizuar me shërbim në fshatin Bularat kanë shkuar menjëherë në drejtim të vendit nga u dëgjuan të shtënat me armë. Në momentin e mbërritjes në vend, punonjësit e policisë janë sulmuar me armë zjarri nga një person i veshur me uniformë ushtarake. Nga zjarri i hapur kundër personelit të policisë u godit dhe u dëmtua automjeti i policisë. Të ndodhur përballë kësaj situatë, punonjësit e policisë kanë kërkuar mbështetje me efektive shpëtimore si dhe janë vënë në ndjekje të autorit të sulmit me armë. Në ndihmë të punonjëseve të policisë kanë mbërritur shërbime të tjera të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë dhe grupi hetimor. Gjatë ndjekjes nga forcat e ardhura të policisë, shtetasi i ar-

matosur ka hapur përsëri zjarr në drejtim të policisë duke rrezikuar seriozisht jetën e tyre. Nisur nga rreziqshmëria që paraqiste shtetasi, i identifikuar si Kostandinos Kaçifa, 35 vjeç, lindur dhe banues në Bularat Gjirokastrë, policia vendore ka kërkuar menjëherë ndihmën e forcave speciale për të bërë të mundur përballimin e situatës së pazakontë për forcat vendore. Me mbërritjen në vendngjarje, kanë ushtruar kontroll në banesën e të dyshuarit. Nga kontrolli i ushtruar në banesë nuk është bërë e mundur gjetja e tij dhe në këtë kohë ka nisur

krejha e zonës. Forcat speciale kanë bërë të mundur lokalizimin e tij në një shtat mali mbi fshatin Bularat. Në momentin e zbulimit nga forcat e policisë, shtetasi Kostandinos Kaçifa, ka hapur menjëherë zjarr ndaj tyre. Forcat speciale janë pozicionuar për të mbrojtur jetën e tyre dhe nëpërmjet megafonit i kanë bërë thirrje të herëpashershme shtetasit që vijonte të qëllonte me armë që të dorëzohej dhe të hidhte armën e zjarrit. Shtetasi Kaçifa ka vijuar të qëllojë kundër forcave speciale për gati 30 minuta, duke rrezikuar seriozisht jetën e tyre. Në



Përplasja e Forcave RENEJA me Kostandinos Kaçifa, dje në Bularat të Gjirokastrës

"Ndalohen patriotët shqiptarë të protestojnë"

Ngjarja, PDIU: Ekstremisti i Agimit të Artë qëllon policinë brenda Shqipërisë

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet denoncoi dje sjelljen e policisë, pasi pretendon se përfaqësues të saj nuk janë lejuar që të protestojnë në ceremonia përkujtimore të të rënëve grekë në luftën italo-greke të viteve '40. Përmes një reagimi për mediat, PDIU thekson se dënon ngjarjen në fjalë që ndodhi në Këlcyrë. Po ashtu PDIU reagoi edhe lidhur me incidentin e rëndë që ndodhi dje në Bularat të Gjirokastrës, ku një person hapi zjarr ndaj makinës së policisë dhe tashmë është në kërkim. "Është e papranueshme që një ekstremist i Agimit të Artë që jetë i pranishëm në territorin shqiptar në ceremoninë e varrezave për ushtarët grek dhe më pas ky ekstremist, qëllon Policinë Shqiptare", thuhet në reagim.



AKUZA

"Ndalohet relativizimi, por të arrestohen dhe të ndalohen ekstremistët e Agimit të Artë dhe "trimoshat e Vorio-Epirit", të cilët kanë marrë zemër nga Rilindësit e rinj, që për turp po ngrenë varrezat e atyre që erdhën si pushtues duke fyer shqiptarët. Kanë harruar mijëra të vrarë, masakruar dhe të shpërngulur që presin të prehen në një varrezë, si për çdo njeri në këtë tokë", - deklaroi PDIU.

"Ndalohet relativizimi, por të arrestohen dhe të ndalohen ekstremistët e Agimit të Artë dhe "trimoshat e Vorio-Epirit", të cilët kanë marrë zemër nga Rilindësit e rinj, që për turp po ngrenë varrezat e atyre që erdhën si pushtues duke fyer shqiptarët. Kanë harruar mijëra të vrarë, masakruar dhe të shpërngulur që presin të prehen në një varrezë, si për çdo njeri në këtë tokë", - deklaroi PDIU.



Ministria e Jashtme shqiptare: Reagimi i Athinës i pajustificueshëm dhe zhgënjyes

Vrasja e ekstremistit grek, Athina: E papranueshme. Rama: Marrëzi

“Të dashur fqinj, bashkohuni me ne“

Valentina Madani

Athina zyrtare e kon sideron të papranueshme vrasjen e ekstremistit grek Konstantinos Kaçifas dhe në Bularat të Gjirokastrës ndërkohë që Shqipërisë i kërkon zbardhjen sa më të shpejtë të kësaj ngjarje. Ministria e Jashtme greke reagoi dhe me një deklaratë për shtyp rreth ngjarjes në Bularat, ku mbeti i vrarë Konstantinos Kaçifas. Në reagim thuhet se vrasja e të riut në çfarëdo rrethane të këtë ndodhur është e papranueshme, ndërsa kjo ministri njofton se ngjarja po ndiqet me interes bashkë me palën shqiptare. Ministria e Jashtme dënon me forcë aksioni, i cili përfundoi me vrasjen e 35-vjeçarit, i cili qëlloni i pari mbi Policinë e Shtetit. Ndërkaq, në reagimin e Policisë së Shtetit, thuhet mes tjerash se pavarësisht thirrjeve të njëpasnjëshme, autori i cili humbi jetën nuk iu bind urdhrave të tyre për të dorëzuar armën. Sipas deklaratës, "autoritetet greke kanë ndjekur ngushtësisht në kontakt me autoritetet shqiptare dhe që nga momenti i parë, incidentin në fshatin Bularat të Shqipërisë, ku një shtetas grek thuhet të ketë hapur zjarr me armë kallashnikov kundër një makine të policisë shqiptare, e cila tentoi arrestimin e tij". "Pak më parë u informuam zyrtarisht se gjatë një shkëmbimi zjarri me forca të policisë shqiptare, Konstantinos Kaçifas mbeti i vdekur", vazhdon deklaratë për shtyp e MPJ greke. "Shprehim keqardhjen tonë të thellë për vdekjen e homojenit grek dhe ngushtëllimet tona familjes së tij", thuhet më tej. "Gjithsesi, është i papranueshëm fakti që operacioni i precipitoni me humbjen e një jete njerëzore", vëren selia e diplomacisë greke. "Presim nga autoritetet shqiptare zbardhjen e plotë të rrethanave në të cilat u humb jeta e këtij qytetari grek dhe do të bëjmë menjëherë veprimet e nevojshme", përfundon deklaratë e Ministrisë së Jashtme greke.

QEVERIA
Kryeministri Edi Rama reagoi në lidhje me ngjarjen



Kryeministri Edi Rama

DEKLARATA

"U informuam për vrasjen e të riut. Me autoritetet shqiptare po ndjekim zhvillimet. Ngushtëllime për vdekjen e homojenit grek. E papranueshme humbja e jetës së një personi në çdo rrethanë. Shprehim keqardhjen tonë për vdekjen e shtetasit grek ngushtëllimet familjes së viktimës. Ne presim që autoritetet shqiptare të sqarojnë plotësisht rrethanat në të cilat u vra shtetasi grek dhe më pas do të marrim masat e duhura menjëherë", - thuhet në reagimin e Athinës zyrtare.

KRYEMINISTRI

Kryeministri Edi Rama reagoi në lidhje me ngjarjen që ndodhi në Bularat të Gjirokastrës, ku një 35-vjeçar u vra gjatë shkëmbimit me armë zjarri të policisë. "Fqinj të dashur! Në vend ta quani të papranueshme humbjen e jetës së një të fandaksuri që qëlloni me plumba luftarakë mbi policinë tonë, e cila bëri vetëm detyrën e saj, bashkohuni me ne në falenderimin e Zotit që asnjë jetë e pafajshme nuk humbi sot nga marrëzia e ekstremistëve", shprehet z.Rama.



Vrasja e 35-vjeçarit në Bularat, ministrja greke: Asnjë flamur nuk u ul

Ministria e Kulturës në Greqi Mirsini Zorba reagoi dhe për vrasjen e 35-vjeçarit. Në një status në 'Facebook', ajo thekson se nuk është ulur asnjë flamur grek në Bularat të Gjirokastrës, por të gjithë sipas saj janë valvitur lart. "Sot, (dije) në varrezat e dëshmorëve në Bularat nderuam dhe ushtarët tanë grekë. Përkujtimore në vendin ku humbën jetën. Emocione mes mave ku luftuan me patriotizëm kundër fashizmit. Kudo flamuj grekë, përfaqësues të qeverisë greke e shqiptare, ambasadore e Greqisë, deputetë, kryebashkiakë, nxënës, banorë të thjeshtë. Vendosëm kurorat, u dëgjuan fjalimet, himni shqiptar e grek, poezi nga fëmijët. U larguam në orën 15.00 qetësisht, pa asnjë problem. Gjatë rrugës u informuam se një minoritar kishte kërcënuar paradite me kallashnikov duke konsideruar marrëveshjen mes dy qeverive për varrezat e dëshmorëve dhe nderimin e kujtimit të tyre një tradhti. Asnjë flamur grek nuk ulën, të gjithë u valëvitën lart. Pas orës 15.00, në rrugën e kthimit u informuam se homojeni u rrethua nga policia, i kërkuar të dorëzohet, nuk u dorëzua dhe e vranë. As që mund të imagjinonim në atmosferën tepër emocionuese të paradites këtë incident tragjik", deklaroi ministrja Zorba.

'Kaçifa', grekët protestë para ambasadës

"Vritini qentë shqiptarë", shpërthejnë në racizëm protestuesit

Qindra protestues grekë, zhvilluan pasditen e djeshme një protestë para ambasadës tonë në Athinë. Me flamujt grekë në duar dhe thirrjet pro Vlorio-Epirit, protestuesit thirrën "Të gjithë grekët tek ambasada e Shqipërisë", Vlorio-Epiri autonom". Pas vrasjes gjatë ditës së djeshme të 35-vjeçarit Kostandinos Kaçifa, në Bularat të Gjirokastrës, kanë reaguuar mjaft qytetarë grek të cilët e kanë konsideruar si një "hero". Faqja e agresorit që u përplas me armë me policinë, është mbushur me sulme ndaj shqiptarëve ku bëjnë përgjegjëse "Tiranën zyrtare". Mjaft mbështetës e kanë quajtur atë një "njeri të pavdekshëm" ku paralajmërojnë kundërpërgjigje. Të gjithë grekët tek ambasada e Shqipërisë. Konstantinos Kaçifa me origjinë nga Bularati ka hyrë në Shqipëri në datë 2 tetor, ndërsa në ditë e fundit kishte vendosur disa flamuj grek në fshat. Ai kishte paralajmëruar në 'Facebook', sulmin ndaj policisë pasi bënte thirrje kundër shqiptarëve. Mësohet se fjalët e fundit të grekut, para se të vritej nga RENEA kanë qenë: Rroftë Greqia, rroftë helezonizmi. Pas vrasjes së 35-vjeçarit sot pasdite në Bularat të Gjirokastrës kanë reaguuar menjëherë institucionet zyrtare greke dhe ato shqiptare. Dije në Athinë u zhvilluan protesta para ambasadës së Shqipërisë, ndërsa të pranishmit kanë shprehur revoltën për vrasjen e Kostandinos Kaçifas, i cili në rrethanat ende të paqarta qëlloni me plumba ndaj policisë shqiptare.

që ndodhi në Bularat të Gjirokastrës, ku një 35-vjeçar u vra gjatë shkëmbimit me armë zjarri të policisë. "Fqinj të dashur! Në vend ta quani të papranueshme humbjen e jetës së një të fandaksuri që qëlloni me plumba luftarakë mbi policinë tonë, e cila bëri vetëm detyrën e saj, bashko-

huni me ne në falenderimin e Zotit që asnjë jetë e pafajshme nuk humbi sot nga marrëzia e ekstremistëve", shprehet z.Rama. Menjëherë pas reagimit të Athinës, reagoi Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, e cila e quan të pajustificuar dhe zhgënjyese deklaratën e

Athinës zyrtare. Ministria shpreh keqardhjen për politizimin e pajustificueshëm të ngjarjes së ndodhur sot në Bularat nga shteti fqinj. Gjithashtu, ajo shpreh zhgënjimin dhe bën thirrje për maturi. Tirana zyrtare në këtë reagim thekson dhe shpreh keqardhje për reagimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë, e cila sipas saj, nuk flet për sulmin ndaj policisë shqiptare, por thekson për humbje jete të papranueshme. "Rrethanat në të cilat humbi jetën shtetasi Kaçifa, janë bërë të ditura zyrtarisht nga autoritetet kompetente shqiptare. Policia e Shtetit ka sqaruar me detaje se kjo është një ngjarje totalisht e izoluar nga aktivitetet e sotme në zonë dhe një rast flagrant agresioni ekstremist ndaj Policisë së Shtetit Shqiptar. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme shpreh zhgënjim për reagimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë, e cila jo vetëm nuk dënon sulmin me armë ndaj forcave tona të rendit, po flet për "humbje jete të papranueshme". Duke bërë thirrje për maturi dhe mosngjyrimet politike e diplomatike të këtij rasti sa të qartë dhe të paprecedentë, i sigurojmë fqinjët tanë se Shqipëria është vend i sigurtë e i qetë për të gjithë shtetasit e saj, përfshirë pa asnjë dallim ata me kombësi greke", thuhet në reagimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë.

AKSIONI I OPOZITËS

INTERVISTA

Ish-ministrja e Integritimit: LSI parti 'agresive'? Nuk ia falim Ramës sjelljen me njerëzit tanë

Zgjedhje të parakohshme, Gjoshja: Xhafaj iku, tani radha e Ramës

"Basha kryeministër? Për ne s'ka rëndësi emri"

Valentina Madani

LSI ka nisur intesivisht përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme lokale. Por ish-ministrja e Integritimit, deputetja Klajda Gjoshja nuk i përkrahon as zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Dorëheqja e ministrit Patmir Xhafaj e shikon si rënie të qeverisë "Rama". Gjoshja thotë për "Gazeta Shqiptare" se ky është vetëm fillimi dhe se tashmë radhën e ka kryeministri Edi Rama. Për shkak të situatës së kriminalitetit gjithnjë në rritje, opozita çdo ditë e më tepër po afrohet pranë pushtetit për shkak të presionit qytetar. Opozita e Bashkuar, shprehet znj. Gjoshja është në unison kundër keqeverisjes së mazhorancës së majtë ndaj ka hapur dyer për këdo që është kundër Edi Ramës. Nuk ka rëndësi për LSI-në se a do të jetë Luzlim Basha apo dikush tjetër kryeministri i ri i Shqipërisë pasi sipas Klajda Gjoshës nuk ka rëndësi emri, por vullneti dhe vizioni i një grupi njerëzish që në plan të parë duhet të kenë rikthimin e shpresës të shqiptarët. Ajo flet edhe për sjelljen e PS-së ndaj njerëzve të LSI-së gjë që e ka bërë edhe më 'agresive' këtë forcë politike ndaj qeverisë "Rama".



Ish-ministrja e Integritimit, deputetja Klajda Gjoshja

Znj.Gjoshja ku është përqendruar aktualisht aktiviteti politik i LSI-së?
Në LSI kemi dy fronte pune, në radhë të parë është detyra jonë si deputet të ndjekim aktualitetin politik, të denoncojmë problemet e qeverisë duke monitoruar punën e saj deri në detaje, por edhe të japim alternativën tonë për një qeverisje më të mirë. E dyta është puna brenda strukturave të LSI dhe evidencimi i njerëzve me vizion të të gjitha fushat.

A ka nisur LSI përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme lokale, siç po bën dhe Partia Demokratike?
Ne kemi nisur përgatitjet tonë që një ditë pas zgjedhjeve të 2017. Kemi struktura solide, të cilat e lehtësojnë shumë edhe punën tonë në terren. Jemi të gatshëm të përballlemi në zgjedhje në çdo moment që do të jetë nevoja.

Si po ecën bashkëpunimi me PD-në? Sipas jush kush tjetër duhet të bëhet pjesë e "Opozitës së bashkuar"?
Është një bashkëpunim që forcohet çdo ditë falë synimit dhe prioritetëve të përbashkëta. Të gjithë janë të mirëpritur t'i bashkohen këtij fronti, ashtu siç bëri edhe PDIU pak muaj më parë.

Realisht në betejën kundër Edi Ramës çfarë e ndan dhe çfarë e bashkon PD-në dhe LSI-në?
Në këtë betejë nuk ka ndarje të palëve opozitare. Ne mund të kemi diferencat tona kur bëhet fjalë për ideologjitë dhe programin, por jo përkundër vendosmërisë tonë për të ndaluar këtë keqverisje.

Pse gjithë kjo përplasje

mes pozitës dhe opozitës, akuza dhe kundërakuza për përfshirje në krim?
Besoj që gjithçka ka qenë e qartë edhe nga përgjimet e bëra publike së fundmi. Ato kanë nxjerrë në pah lidhjen e ngushtë të politikës me krimin dhe kjo e fundit ka mundur të infiltrohet të ekonomisë shqiptare si dhe në zgjedhjet duke dëmtuar rëndë votën e qytetarëve shqiptarë dhe demokracinë. Besoj se askush nuk mund të pajtohet me këtë fenomen.

Çfarë përfshin aksioni opozitar, brenda tij a bën pjesë e dëgjia e mandateve për të cilat kryetarja e LSI-së është shprehur se janë fituar me gjak?
Dëgjia e mandateve është aspekti i fundit për t'u munduar pasi realisht LSI ka sakrificuar shumë në këto zgjedhje dhe mbi të gjitha elektoratit ynë ka qenë në një presion të tmerrshëm. Ka shumë opsione të tjera të cilat opozita i ka bërë prezente me aksionin e saj, të cilat jemi të bindur që do të çojnë në çlirimin e këtij kaosi total në të cilin ka hyrë vendi.

Jo rrallë LSI është

shtfaqur më "agresive" sesa PD në përballjen me mazhorancën e majtë. Çfarë e bën më të ashpër LSI-në kundër Edi Ramës?
Është e rëndësishme të cilësojmë faktin se LSI e një mirë mënyrën se si qeveris Kryeministri, intrigat e përdorura prej tij por nga ana tjetër ne është vështirë të falim sjelljen e mazhorancës dhe të kryeministrit me njerëzit e LSI, të cilët janë qytetarë të thjeshtë dhe të ndershëm të këtij vendi.

Kush do të jetë lëvizja politike e radhës e opozitës?
Ndonjëherë është e vështirë të planifikosh lëvizje në një politikë si kjo e jona që të surprizon çdo moment. Pas ngjarjes së fundit me largimin e Z.Patmir Xhafaj, rruga e opozitës tashmë është e hapur për të kërkuar largimin e kryeministrit.

...Por kryeministri nuk lëkën?
Dorëheqja e z.Xhafaj është vetëm fillimi i asaj çfarë pritet të ndodhë më pas. ...Dhe çfarë do të ndodhë më pas...? Ne nuk jemi njohur ende me rrethanat në të cilat ka

DORËHEQJA
"Ne nuk jemi njohur ende me rrethanat në të cilat ka ndodhur dorëheqja, gjithsesi një gjë është e sigurt, situata ka arritur në pikën e vlimit, kupa është mbushur plot dhe tani ka filluar të derdhet. Dorëheqja e z.Xhafaj është vetëm fillimi i asaj çfarë pritet të ndodhë më pas. "-tha znj.Klajda Gjoshja.

'AGRESIVITETI'
"Është e rëndësishme të cilësojmë faktin se LSI e një mirë mënyrën se si qeveris kryeministri, intrigat e përdorura prej tij, por nga ana tjetër ne është vështirë të falim sjelljen e mazhorancës dhe të kryeministrit me njerëzit e LSI, të cilët janë qytetarë të thjeshtë dhe të ndershëm të këtij vendi"-deklaroi znj.Gjoshja.



neti dhe vizioni i një grupi njerëzish që në plan të parë duhet të kenë rikthimin e shpresës të shqiptarët.

Ekziston "frika" se LSI mund të shkëputet sërisht nga aleanca me PD-në për një rimarrëveshje tjetër me PS-në. A mund të ndodhë sërisht një lëvizje e tillë?

Pozicionimi ynë është i qartë. Ne kemi një prioritet përpara dhe jemi të vendosur për këtë.

KQZ aktualisht është në një ndërç për shkak të vakancave të krijuara, ndërkohë që PS i ka dërguar dy propozimet e saj për anëtarë të Komisionit, po LSI si do të veprojë?

Ne kemi një pjesë e Komisionit Zgjedhor apo të Komisionit të Posaçëm, jemi munduar të japim alternativën tonë. Për ne reforma zgjedhore është kyçe, Jo vetëm për procesion e integritimit evropian, por është kyçe, sepse të kesh zgjedhje të lira, normalisht do të thotë që ti të kesh demokraci, e cila ka munguar në këtë vend prej vitesh. Ndaj dhe ne jemi munduar të ishim tejet konstruktiv mbi këtë çështje, por asnjëherë nuk kemi gjetur mundësinë për të bashkëpunuar dhe për të shpallur ato ide të cilat duhen konkluduar.

Cila është kjo?
Nuk është e nevojshme të diskutojmë për të gjithë sistemin. Sistemin ne mund ta kemi mazhoritar, mund ta kemi proporcional, mund ta kemi kombëtar e kështu me radhë i vendosim me radhë në tryezë të

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përbarimorë "Besa 2010"

SHPLLJE ANKANDI

Më datë 26 nëntor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përbarimorë do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e III-të, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq.1, ZK.8603, sip. 105 m2 me çmim fillestar 2976750 lek. b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, sip.513.4 m2 me çmim fillestar 22640940 lek
Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN" shpk (NUIS J97201218L)
Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Njoftim për shitje me ankand të tretë

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e dorëzuesin K Sula te ndodhur ne Mallakaster. Pasuria që shitet në ankand përbehet nga:
* "Pasuria A" me nr. 206/48, me sipërfaqe 2500 m2 në ZK 2869 vol 5 fq.31, dhe "A" me nr.206/7 me vol 4, faqe 244, në ZK 2869 vol me sipërfaqe 500 m2.
Ankandi tretë i sipërfaqes totale 3.000 m2 fillon me çmim fillestar 806.400 lekë
* "Pasuria" Nderetesa "pjesë e vecuar me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në ZK 2869 Ankandi tretë fillon me çmim fillestar 252.419 lekë
Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet dt.23.11.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, zyra.5. Kont tel. 0672082543, e-mailit:ilir_dervishaj@yahoo.com. WEB www.powerjustice-al.com.

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar ne nenin 567.568 e vijues te K.P.LC do të zhvillojë ankandin e pare për pasurinë e pales debitore B Kambaraj dhe L Kambaraj. Pasuria që shitet në ankand përbehet nga:
* "Trulli" e Godine te kateshe ", me numer pasurie 14283 ne ZK Nr.8602, volumi 35, faqe 144, trulli 300 m2, sipërfaqe e kati perche 117.9 m2 ne Lagjen 10 Korrikne Vlore
Ankandi i pasurisë fillon me çmim fillestar në masën prej 8.960.000 Lekë
Ankandi qendron i hapur 15 dite dhe do të zhvillohet në datë 08.11.2018 në orën 15:00 në Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 2, Tiranë. Ofertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit: ilir_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.



Kreu i PD: Famir Xhafaj iku pa arrestuar Dakon, manipuloi dosje hetimore

Basha: Nuk ka gjeneral, me apo pa spaleta, që ta shpëtojë Dakon

"Audio-përgjimi i Habilajt, për një muaj 5 mln euro"

Valentina Madani

Përtej të gjithë ske narëve për dorëheqjen e Xhafajt, kreu i PD-së Lulzim Basha ka bindjen e plotë se ministri Famir Xhafaj u largua për t'i ikur përgjegjësisë së manipulimit të provave për çështjen e të vëllait të tij, ndërsa pika kulminante sipas tij ishte mosarrestimi i kryebashkiakut të Durrësit Vangjush Dako. Gjatë bashkëbisedimit me banorët e Manzës në Durrës, z.Basha theksoi se Xhafaj kishte frikë të përballjeve dhe të arrestonte kryebashkiakun e Durrësit. "Tash dy vjet ne kemi denoncuar dosjen hetimore 339. Dosja hetimore 339 vuri në lëvizje faktorin ndërkombëtar dhe e vuri me shtatulla pas muri Famir Xhafaj. Faktori ndërkombëtar e detyroi atë të fillonte arrestimin e disa prej bandave kryesore të krimit me të cilat Edi Rama mori votat qershorin e vitit të kaluar. U arrestuan Bajrat në Shkodër. U arrestuan Ndokët në Lezhë. U arrestuan Avdyllët në Shijak. Por Famir Xhafaj, si një vasal i vërtetë i Edi Ramës nuk pati guxim të arrestonte Vangjush Dakon, personazhin kryesor dhe kokën e shtabit të shpëtimtarëve të votave, siç e dini fare mirë këtu në Manzë, në Sukth dhe në gjithë zonën e Durrësit. Ky ishte momenti kur faktori ndërkombëtar e kuptoi se Famir Xhafaj nuk është gjë tjetër veçse një ushtar i bindur i Edi Ramës", deklaroi z.Basha. Për kreun demokrat, largimi i ministrit është dëshmi e forcës së opozitës. Ai përmendi se pas këtij largimi të papritur të Xhafajt fshihet manipulimi i dosjes hetimore për vëllain e tij, Agron Xhafaj. "Famir Xhafaj është larguar nga frika e përballjes me përgjegjësitë e tij ligjore dhe politike për manipulimin e hetimit ndaj vartësve të tij, drejtorit të Përgjithshëm Ardi Veliut dhe njerëzve të tjerë të përfshirë në manipulimin e dosjes hetimore për vëllain e tij", u shpreh z.Basha. Ai paralajmëroi kreun e qeverisë se nuk do ia dalë të ndalojë prangosjen e kryebashkiakut të Durrësit Vangjush Dako, edhe me emërimin në krye të Ministrisë së Brendshme të Sander Lleshit. "Nuk ka gjeneral, me apo pa spaleta ta shpëtojë, Vangjush Dako e ka vendin në burg, dhe në burg do të shkojë një orë e më parë, për korrupsionin, për vjedhjen, për bashkëpunimin me kriminelët, për shndërrimin e Durrësit, të kësaj treve fisnike, në një çiflig të krimit, aty e ka ven-



Kreu i PD-së Lulzim Basha

VETINGU
Z.Basha deklaroi dje se pastrimi i politikës dhe dekriminalizimi i zgjedhjeve janë jetike për demokracinë dhe stabilitetin e vendit. Teksa publikoi një video në lidhje me përgjimet e Habilajve, ku flitet për ish-ministrin Tahiri, për blerjen e votave, si dhe atë ku mendohet se është i përfshirë kryebashkiaku i Durrësit, Basha shprehet se vetëm ndarja e politikës nga krimi mund të sigurojë votë të lirë.

LËVIZJA

"Ndonjëherë është e vështirë të planifikosh lëvizje në një politikë si kjo e jona që të surprizon çdo moment. Pas ngjarjes së fundit me largimin e Z.Fatmir Xhafaj, rruga e opozitës tashmë është e hapur për të kërkuar largimin e kryeministrit", - shprehet deputetja e LSI.

gjithe sistemet. Çështja është të gjetja e mekanizmit për shpëtimtarët e votave dhe unë besoj që ky është ngërçi më i madh që kanë zgjedhjet sot në Shqipëri. Si duhet të veprojmë ne për të ndaluar këtë fenomen që i ka vënë në rrezik zgjedhjet në Shqipëri prej shumë kohësh tashmë, por kanë qenë tejet evidente në zgjedhjet e fundit, ato të 2017.

A do të ketë bisedime në opozitë mes pozitës dhe opozitës për çështjen e reformës së re zgjedhore?

Ne e kemi kryer besoj si opozitë, por edhe si LSI të gjitha detyrat dhe etapat tona, por të shohësh mazhorancën që shkon në mënyrë të njëanshme, bën një show publik, duke i ftuar të gjithë dhe duke thënë që ky është një draft i ekspertëve, ndërkohë që ai nuk është, ai është një draft i PS apo i figurave politike të PS, pra nuk është një draft i mirëfilltë ekspertësh, i cili duhet besuar. Është totalisht i njëanshëm për t'u vendosur në tavolinë dhe për të thënë hajde votojeni. Kjo është një reformë që shkonin përtej votave të Partisë Socialiste. Është një reformë që shkon te qytetarët shqiptarë, të liria që ata duhet të kenë për zgjedhjen e qeverive të ardhshme, apo dhe për pushteti lokal. Ndaj dhe nuk mund të serviret në atë mënyrë. Ne kërkojmë një qasje ndryshe, të cilën mazhoranca nuk e ka në vullnetin e saj politik. Pra, nuk e ka dialo-

gun si bazë në themelet e saj.

Si ish-ministër e Integrimit çfarë e pengon hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në?

Unë e kam shprehur prej shumë kohësh skepticizmin tim për mundësinë e çeljes së negociatave. Nuk është një proces që mund të përmbyset nëpërmjet propagandës politike të mazhorancës. Ky është një proces letrash, transformimi, reformatimi dhe modernizimi me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve shqiptar dhe përfundimin e standardeve me ato të BE. Kjo qeveri për fat të keq e ka braktisur prej kohësh qeverisjen e vendit, duke shkatërruar institucionet dhe duke çoroditur administratën publike. Integrimi nuk mund të kryhet pa kapacitetet njerëzore dhe kjo mungon sot me shumë se çdo gjë tjetër. Profesionistët kanë zgjedhur të largohen nga Shqipëria pasi i mungon vlerësimi dhe siguria për pozicionin e punës. Reformat në të shumtën e rasteve janë përdorur për kapjen e pushtetit dhe jo për t'u vënë në dispozicion të qytetarëve. Muajt kanë ikur shpejt dhe për fat të keq asgjë nuk ka shkuar në favor të perspektivës tonë europiane.

A besoni se negociatat do të hapen gjatë qeverisjes "Rama"?

Fatkeqësisht jo, nuk e besoj këtë. Vendi duhet të çlirohet nga ky moment i vështirë dhe ka nevojë për një qeveri bashkëpunuese që punon për qytetarët e saj.

"Të hënën në gjykatë padia për shpifje"

Basha në Durrës, Dako: O peshk i Saliut, ik fli gjumë

Kreu i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako reagoi dje pas akuzave të kreut të PD-së Lulzim Basha gjatë një takimi me banorët e Manzës. Përmes një statusi në 'Facebook' Dako ironizoi Bashën për vizitën e këtij të fundit në Durrës, ndërsa e quajti sërish 'peshk rezervati'. Kreu i Bashkisë së Durrësit tha se Basha shpif dhe se për këtë do të depozitohet të hënën padinë për shpifje në gjykatë. "O Lulzim o toçi i Saliut! Po



si mund të vish në Durrës si ata fuksat e viteve 80 me pantallona doku dhe guhën si peshk rezervati? Është si thjeshtë se ti je një peshk

rezervati dhe më e shumta mund të të hajë Sallianji se Saliu s'bëhet llaf. Po ato që përsërite prapë si skapamento e prishur ishalla s'do t'i kesh harruar kur të vish në gjyqin e radhës. Kurse atë lejen për pistën në det mirë bëre që s'e përmende prapë, se do e kishe ngrënë dyfish padinë për atë! Ik fli gjumë tani te vaska e peshkut ku të rrit Saliu me Kunatin, se Dakon këtu e ke, në Durrës me telefon në dorë ditë-natë o toçi!", deklaroi z.Dako.

din bashkë me kriminelët e tjerë, ata që janë prapa hekurave dhe shumë të tjerë që do të rikthehen e do të përfundojnë aty", - theksoi z.Basha.

AUDIO-PËRGJIMI

Kreu i PD, Lulzim Basha akuzon PS për tri raste të vjedhjes së votave në 2017. Në një video të publikuar në FB ai i referohet dosjes Habilaj, por edhe përgjimeve të dosjes Avdyllaj. Duke folur për zgjedhjet në Tiranë, Basha publikon një përgjim të Moisi Habilajt. Moisi Habilaj: Ai (Saimir Tahiri) për një muaj mund të ketë bërë hiç, hiç, hiç... 5 milionë euro. Sabi: Po ashtu i lë në fushatë ai, o Moisi! Videoja vazhdon me dosjen 339, ku sipas PD një person komunikon me Niçen dhe flet për 6 persona që do të votojnë kundrejt pagesës. Ngjarje e zhvilluar një ditë para votimeve. 069 56 39 642: Kam ca mbiemra Kurti, kam zonjën këtu. 6 veta janë! Niçja: Hajt se të marr unë! 069 56 39 642: Thuaj Vangjushit t'i

japim ndonjë lekë, që të votojmë. Basha vijon me një tjetër përgjim të dy ditëve pas votimeve, ku sipas tij është Dako që komunikon me Niçen për një person të quajtur Astriti. Basha sqaron se Altin Avdyllaj është Niçja dhe është anëtar i bandës Avdyllaj, i arrestuar për trafik droge. Me tej Basha zbardh konkludimet e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ku thuhet se nga përgjimet e telefonave celularë në përdorim të shtetasit Gjevi Ndoka evidentohet se para dhe gjatë fushatës zgjedhore të 2017 është përfshirë në mënyrë aktive duke ofruar dhe dhënë të holla për zgjedhësit me qëllim votimin për siglën e PS. Videomesazhi i Bashës mbyllet me një raport të ekspertit të Këshillit të Europës për zgjedhjet, ku thuhet se nga studimet e bëra në Shqipëri, 20% e shqiptarëve u janë ofruar para në zgjedhjet e 2017. Ndërsa shtetlerja e votës re-

alizohehet në disa mënyra në këmbim të parave, këmbim të mallrave, në punësim në administratë, apo me legalizim e banesave. Për kreun e demokratëve, beteja me kriminelin është e fituar vetëm pas largimit të kryeministrit Rama, të cilin opozita e akuzon si arkitekt të vënies së shtetit në shërbim të bandave. Kreu i PD-së foli edhe për një personazh, që e etiketoi si Rrumi dhe e konsideroi si ushtar të Vangjush Dakos. "Vendi nuk qeveriset nga një qeveri dhe një kryeministër i zgjedhur me votën e popullit. Kur vjen në pushtet me kërcënimet e Rrumit (Rumi) e ka ky që bënte kërcënimet për zgjedhje në këtë zonë, një ushtar i Xhuxhit, qenka në Sukth). Pra, kur vjen në pushtet mbi zullumet e Rrumit e të Gjush Dakos, mendjen e ke të punosh për Rrumin dhe Gjush Dakon dhe për bandat e tjera të Durrësit dhe Shijakut", - theksoi kreu i PD-së.

DOREHEQJA DEKRETI

Fatmir Xhafaj edhe të dielën në punë, PD: Po largojnë orenditë nga zyra

Sandër Lleshi në pikëpyetje? Dyshime për rolin e tij në 21 janar

Pollo-Lleshit: Çfarë këshille i dhe Ramës për drogën?

Valentina Madani

Ministri në detyrë Fatmir Xhafaj pa varësisht dorëheqjes edhe dje punoi në zyrën e tij. Ministri i Brendshëm i dorëhequr, Fatmir Xhafaj do të vazhdojë të qëndrojë edhe për disa ditë në detyrë. Të paktën deri ditën e enjte, kur është parashikuar që në parlament të votohet dekreti i shkarkimit. Kreu i shtetit e firmosi shkarkimin e Xhafajt vetëm pak orë pasi kryeministri Rama njoftoi se kishte pranuar dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, por Meta nuk është shprehur ende për propozimin e shefit të qeverisë, këshilltarit të tij, Sandër Lleshi, por të marrë drejtimin e dikasterit të Rendit, më i sulmuari në kabinetin e Ramës. Presidenti ka 7 ditë kohë, në të cilën bën të gjitha verifikimet rreth propozimit, ndërsa burimet pranë tij thonë se lëvizja mund të jetë në fillim të javës. Seanca e parlamentit është të enjten, kur edhe do të votohet dekreti i shkarkimit të Fatmir Xhafaj si ministër i Brendshëm. E nëse Meta ka firmosur emërimin e ri, në seancë do të kalojë edhe dekreti i pasuesit të Xhafajt, gjeneralit Sandër Lleshi. Në këto 5 vite të qeverisjes së socialisteve, pas Tahirit dhe Xhafajt, Lleshi do të jetë ushtaraku i dytë që do të drejtojë këtë dikaster, pas Dritan Demirajt, që qëndroi në detyrë gjatë muajve të paktit Rama-Basha. Nga ana e saj PD përmes deputetit Klevis Balliu shprehet se çdo ministër bashkë me Ramën polargojnë orenditë e tyre nga zyrat shtetërore. Sipas Balliut "është në genetikën e PS rënia, humbja, dështimi, pasi e mira mbizotëron gjithmonë mbi të keqen". "Pse ra rilindja? Pas rënies së Ministrisë të Brendshëm, qeveria praktikisht ka rënë. Tashmë është fakt se çdo ministër më në krye Edi Ramën sot polargojnë orenditë e tyre nga zyrat shtetërore, pasi janë të vetdijshëm që koha e tyre mori fund.

Dhe tashmë do i duhet të përballen me drejtësinë. Por

NGJELA

"Nëse kryeministri cerebral Rama ka përdorur gjithë rrugësh me Xhafajin, dy janë rrugët: ose Edi Rama duhet të japë dorëheqjen sa më shpejt që të jetë e mundur; ose ministri Xhafaj duhet t'i drejtohet gjykatës apo dhe prokurorisë me padi ose civile, ose penale kundër kryeministrit të tij. Në fakt, padia në vetvete do të ishte një akt i madh historik kundër frymës së rrugës që ka 100-vjejt që drejton shtetin dhe qeveritë shqiptare", tha z.Ngjela.



Sandër Lleshi, këshilltari i kryeministrit

pse ra rilindja?

Rilindja ra për një fakt shumë të thjeshtë. Është në genetikën e PS rënia, humbja, dështimi, pasi e mira mbizotëron gjithmonë mbi të keqen", shkruan deputeti i PD-së.

PIKËPYETJA

Kryeministri Edi Rama dorëzoi para dy ditëve në Presidencë dy dekrete, i pari për shkarkimin e Fatmir Xhafajt dhe i dyti për emërimin në vend të tij të Gjeneralit Sandër Lleshi. Por nëse për shkarkimin e Xhafajt, firma e kreut të shtetit ishte e menjëhershme, nuk ndodhi e njëjta gjë për dekretin e emërimit në detyrë të Sandër Lleshit. Vizion Plus, raportoi dje se siç parashikohet në ligj, Presidencë ka kërkuar informacion mbi figurën e Sandër Lleshit në të gjithë institucionet ligjzbatuese, një procedurë kjo që ndiqet në të gjitha rastet e personave që presin dekretin e kreut të shtetit. Informacioni është kërkuar dhe nga Shërbimi Informativ Shtetëror dhe Shërbimi Informativ i Ushtirisë. Të njëjta burime saktësojnë se shkak kryesor për këto informacione të kërkuara nga shërbimet sekrete është ngjarja e 21 janarit 2011, ku 4 persona mbetën të vrarë përpara kryeministrit, në një protestë të thirrur nga opozita e kohës pas publikimit të një video-përgjimi mes Dritan Priftit dhe Ilir Metës. Në atë kohë, Lleshi ka mbajtur pos-

tin e zv.shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Për shumë kohë u fol nëse ka pasur një plan të ushtrisë për shpalljen e shtetërore në vend, pas ngjarjes se konsideruar si një puç nga ish-kryeministri Berisha. Por ministri i Mbrojtjes i kohës, Arben Imami e ka hedhur poshtë këtë tezë, duke deklaruar se nuk ka pasur asnjë tentativë për të përfshirë Forcat e Armatosura, por vetëm sugjerime të karakterit informues nëse mund të përdorej ushtria, pasi në disa vende anëtare të NATO-s, në situata të ngjashme, lejohet angazhimi i tyre. Tashmë Presidencë ka kërkuar nga SHISH dhe SHIU informacione të detajuara lidhur me periudhën që Lleshi ka mbajtur këtë post, si dhe mbi rolin e Forcave të Armatosura në ngjarjen e rëndë të 21 janarit. Deri në mbërritjen e përgjigjeve dekreti për emërimin e Lleshit në këtë detyrë do të mbesë në tryezën e Presidentit Ilir Meta.

KËSHILLA

Aleksandër Lleshi, pritet të zëvendësojë ish-ministrin e Brendshëm Fatmir Xhafaj, por deputeti i PD, Genc Pollo, ia drejtoi dje 8 pyetje ministrit të ri. Pollo shkruan se nuk ka asnjë parargykim për Lleshin, këshilltar i kryeministrit për çështjet e sigurisë që nga viti 2013, por do të don të t'i bënte disa pyetje. "Cilat janë këshillat që z. Lleshi i dha

kryeministrit: 1- kur u mor vesh se avionët të vegjël transportonin drogë nga Shqipëria në Itali duke përdorur aeroporte ushtarake si Gjadri apo edhe aerodrome e pista rrethore; 2- kur u bë e qartë se mohimi nga Ministria e Mbrojtjes i përdorimit të aeroporteve nga avionët e drogës rezultoi i pavërtetë; 3- kur Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Bazo në maj 2014 pretendoi publikisht se është i pamundur transpor-



BERISHA: SANDËR LLESHI, GJENERAL ME DY RROGA SHTETËRORE

Ish-kryeministri Sali Berisha shkruan në profilin e tij në "Facebook" se Sandër Lleshi është një gjeneral me dy rroga shtetërore. Duke iu referuar si zakonisht, siç Berisha e quan "qytetit dixhital", ai shkruan se ministri i ri Brendshëm që pret të marrë detyrën ka marrë gjatë kësaj dy rroga, njërin tek Ministria e Mbrojtjes dhe tjetrin si këshilltar i kryeministrit. Berisha shkruan se Sandër Lleshi nuk i ka kthyer kurrë leket për këtë abuzim dhe në fund të statusit shtron pyetjen: Pra, ky njeri që tani bëhet ministër, sa rroga do të marrë? Sandër Lleshi është propozuar nga kryeministri Rama për ministër i Brendshëm pas dorëheqjes së befasishme të Xhafajt dhe tani pret të dekretohet nga presidenti Meta.



VASILI: MINISTRIA E BRENDSHME TENDER I PËRJETSHËM I RAMËS

Për kreun e deputetëve të LSI-së Petrit Vasili "Ministria e Brendshme është tender i përjetshëm i kryeministrit Edi Rama". Duke marrë shkas nga dorëheqja e dëshme e Xhafaj nga Ministria e Brendshme, Vasili tha se në "tenderin" në fjalë ftohen të gjithë ata që janë pro dhe garant krimin. "Ministria e Brendshme tender i përjetshëm i kryeministrit. Ministria e Brendshme ka pushuar së qeni një instrument ekzekutiv dhe politik i fuqishëm dhe pa kompromis ndaj krimin dhe trafikëve. Ajo është thjeshtë një tender i hapur, të cilin e fiton kushdo që garanton se do mbetet e tillë pra: luftesja e krimin dhe luftesja më e madhe e tij", shprehet z.Vasili.

ti i drogës me avion "megë hapësirën ajrore të Shqipërisë e monitoron NATO", çka ishte tërësisht e gënjeshtërt pasi NATO nuk ka objekt aviacionin civil e aq më pak aeroplanët privatë; 4- kur debatohej në publik se mbjellja masive e drogës vendin tonë në vitin 2016 përbente rrezik për sigurinë publike e kombëtare; 5- kur raportet e Europolit, Departamentit të Shtetit të ShBA, Zyrës për Drogën e Krimin të OKB (UNODC) dhanë alarmin pas vitit 2016 për kanabizimin e vendit e pasojat e rrezikshme të tij; 6- kur rezultoi

se bandat e narkotrafikantëve kontrollonin radarrë e bregdetit dhe i fiknin ata sa herë u nevojitej atyre për fshehur transportet e drogës; 7- kur një ministër i qeverisë Rama sugjeroi ndërhyrjen antidrogë të Ushtrisë pasi Policia konsiderohej e kanabizuar; 8- kur u hartua e miratua ligji mbi FA, i cili u rrëzua në vitin 2014 nga Gjykata Kushtetuese pasi transferonte të gjithë pushtetet e organeve kushtetuese tek kryeministri duke e bërë atë "edhe komandant edhe komisar", siç u shprehën ekspertët", shkruan z.Pollo.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE BANKA E SHQIPËRISE DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje dhe implementim i disa pajisjeve të rritit për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 12,700,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktësisht prej 500 Lekë, pranë një bankë tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutites: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje dhe implementim i disa pajisjeve të rritit për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 23 Nentor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

EMIGRANTËT NË GREQI PROBLEMATIKAT

Ndërmjetësi ndërkulturor: Kemi dërguar kërkesë në Ministrinë e Brendshme greke

Fatos Malaj: Blllokohen lejet e qëndrimit për mijëra emigrantë në Greqi

"Gruaja e ve paguan 1 mijë euro për lejen e jashtëzakonshme"

Voltiza Duro

Sipas ligjit më të fundit grek, lejet për arsyet e jashtëzakonshme nuk po merren nga emigrantët shqiptarë që jetojnë e punojnë në shtetin helen. Në një intervistë për Gazeta Shqiptare, Fatos Malaj, ndërmjetësi ndërkulturor në Ministrinë e Emigracionit në Greqi, njëkohësisht drejtues i shoqatës "Përkrahja" tregon se janë shumë emigrantë të vjetër shqiptarë që kanë humbur të drejtën e rinovimit të lejes së qëndrimit, sipas procedurës normale. Ai më tej thekson se edhe emigrantët shqiptarë që kanë aktivitet privat, gjatë ndryshimit të të dhënave personale, organi kompetent i Shërbimit Financiar Publik nuk është në gjendje të verifikojë lejen e qëndrimit të rivendosur në pasaportën e re, çfarë shkakton pengesë serioze në çdo transaksion. Për zgjidhjen e situatës, organizata "Përkrahje" (Arogi) në Greqi ka ngritur dy çështje themelore për ecurinë e procesit të legalizimit të emigrantëve shqiptarë.

Organizata "Përkrahja" në Greqi ka nisur një kërkesë drejt Ministrisë së Brendshme greke për dy problematika që shqetësojnë shqiptarët që jetojnë e punojnë në Greqi. Mund ta shpjegojmë më specifikisht kërkesën tuaj?

Organizata "Përkrahje" (Arogi) në Greqi ka ngritur dy çështje themelore për ecurinë e procesit të legalizimit të emigrantëve shqiptarë. Kështu unë si kreu i kësaj shoqate për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë në shtetin helen kam dërguar një kërkesë drejt ministrisë së Brendshme Greke dhe sekretarisë së përgjithshme të politikës për emigracionin.

Cilat janë problematikat që konstatuat mbi procesin e legalizimit të emigrantëve?

Me ligjin e fundit, lejet për arsye të jashtëzakonshme u transformuan nga dy në tre-vjeçare. Vihet re se për arsye teknike, në mungesë të informimit të sistemit elektronik, kategoritë e këtyre lejeve është e pamundur të plotësohen nga nëpunësit, e si rrjedhim të lëshohen. Shitje të kategorisë e lejeve të jashtëzakonshme përf-

TAKSAT E REJA

Po, ka taksa të reja. Në të gjitha ato raste kur emigranti dorëzon kërkesën për leje qëndrimi për arsye humanitare, duhet të paguajë edhe një tarifë prej 100 eurosh. Ndërsa kur personi bën kërkesë për terapi kundër vendimit për refuzim apo heqje të lejes së qëndrimit, tarifa që duhet të paguajë është 50 euro.



ZGJIDHJA E PROBLEMIT

Organizata "Përkrahje" ka dhe zgjidhjen më të shpejtë e praktike, dërgesa e një udhëzimi nga ministria e Financave në sektorin përkatës të pranojë vërtetimin e zyrës së drejtorisë për të huajt për ndryshimin e pasaportës ose pajisjen me një vërtetim ku të referohen të dhënat e pasaportës së zëvendësuar dhe të pasaportës në fuqi.

shin një kategori të gjerë emigrantësh "të vjetër" në Greqi, që për mungesë dokumentesh apo arsye të tjera, kanë humbur të drejtën e rinovimit të lejes së qëndrimit, sipas procedurës normale, por plotësojnë kriterin bazë të qëndrimit të vazhdueshëm 7-vjeçar në vend.

Si po ndiqet çështja për zgjidhjen e problematikës deri më tani?

Sektori përkatës i drejtorisë për të huajt në Administratën e Decentralizuar është në pritje të verifikimit të problemit dhe zgjidhjes së ngërçit, që bllokon me qindra emigrantë pa dokumentacion, pas kaq vitesh pune e qëndrimi në Greqi.

Mund të na shpjegojmë më specifikisht kërkesën tjetër që i keni nisur Ministrisë së Brendshme greke?

Çështja e dytë që parashtrohet në kërkesë referohet në emigrantët shqiptarë që kanë aktivitet privat, të cilët tashmë pajisen me leje qëndrimi biometrike. Gjatë ndryshimit të të dhënave personale, veçanërisht të pasaportës, organi kompetent i Shërbimit Financiar Publik nuk është në gjendje të verifikojë lejen e qëndrimit të rivendosur në pasaportën e re, çfarë shkakton

ULJE TARIFASH

Vlen të theksoj se tarifat vazhdojnë të mbeten "të kripura" për lejet "kombëtare", që dalin sipas ligjit grek. Kështu për lejen e qëndrimit 10-vjeçare do të paguhet një tarifë prej 900 euro; për lejen 5 vjeçare të brezit të dytë duhet paguar 300 euro. Ndërkohë për lejen për veprimtari investuese, ka një katërfishim tarifash ku nga 500 euro bëhet 2.000 euro.

pengesë serioze në çdo transaksion.

Cila është zgjidhja që ju keni propozuar për problemin e sipërpërmendur?

Organizata "Përkrahje" ka dhe zgjidhjen më të shpejtë e praktike, dërgesa e një udhëzimi nga ministria e Financave në sektorin përkatës të pranojë vërtetimin e zyrës së drejtorisë për të huajt për ndryshimin e pasaportës ose pajisjen me një vërtetim ku të referohen të dhënat e pasaportës së zëvendësuar dhe të pasaportës në fuqi. Me shprehjen se thirrja e organizatës do të dëgjohet, e problemet paraqitura do të zgjidhen së shpejti, duke u ardhur në ndihmë

duhet të paguajë një shumë kolosale, sidomos me të dhënat e sotme ekonomike në vend, sipas vendimeve të fundit për lejet e qëndrimit, marrë nga qeveria Siriza-Anel.

Sipas legjislacionit helen, a do të ketë taksa të reja që rëndojnë emigrantët shqiptarë në Greqi?

Po, ka taksa të reja. Në të gjitha ato raste kur emigranti dorëzon kërkesën për leje qëndrimi për arsye humanitare, duhet të paguajë edhe një tarifë prej 100 eurosh. Ndërsa kur personi bën kërkesë për terapi kundër vendimit për refuzim apo heqje të lejes së qëndrimit, tarifa që duhet të paguajë është 50 euro. Emigranti duhet të paguajë një tarifë prej 100 euro për rinxjerrjen e lejes së qëndrimit të të gjitha kategorive (si në rastet kur humbet apo dëmtohet). Në këto raste, përveç paravolos (tarifës) paguan edhe 16 euro që është vlera e kartës biometrike të lejes së qëndrimit.

A do të ketë ndonjë ulje tarifash për lejet kombëtare që dalin nga ligji grek?

Vlen të theksoj se tarifat vazhdojnë të mbeten "të kripura" për lejet "kombëtare", që dalin sipas ligjit grek. Kështu për le-

jen e qëndrimit 10-vjeçare do të paguhet një tarifë prej 900 euro; për lejen 5 vjeçare të brezit të dytë duhet paguar 300 euro. Ndërkohë për lejen për veprimtari investuese, ka një katërfishim tarifash ku nga 500 euro bëhet 2.000 euro. Gjithashtu, për personat e pavarur nga ana ekonomike, tarifa ishte 0, dhe do të bëhet 1.000 euro. Një katërfishim tarifash ka edhe për lejen e përhershme të investitorit ku nga 500 euro që paguanin para, tashmë emigrantët duhet të paguajnë plot 2000 euro.

Sakaq për punësimin sezonal të shtetasve nga vendet e treta, punëdhënësi duhet të paguajë 100 euro, nga 50 që paguante deri më tani.

Po për globat cilat janë tarifash që do të aplikohen për emigrantët shqiptarë?

Dua të theksoj dhe të informoj emigrantët se do të ketë një dyfishim të gjobave. Kështu gjoba vendoset kur emigranti paraqet me vonesë deri një muaj kërkesën për leje qëndrimi. Kjo gjobë mbetet 50 euro për pjesëtarët e familjes të shtetasit grek apo shtetasit të BE. Kur nuk informon për ndryshimin e të dhënave personale dhe adresën, emigranti do të ketë një gjobë prej 100 euro, ndërsa në rast përsëritjeje gjoba do të jetë 200 euro.

Nr dosjeve	VKM	Emër Mbiemër	Nr dosjeve	VKM	Emër Mbiemër	Nr dosjeve	VKM	Emër Mbiemër	Nr dosjeve	VKM	Emër Mbiemër	Nr dosjeve	VKM	Emër Mbiemër	Nr dosjeve	VKM	Emër Mbiemër
5223	1699	Skënder Lulolli	7147	784	Bahri Omari	8186	784	Gajo Goreni	9392	1699	Bajram Sherifi	10771	707	Aleks Karablini	12487	1699	Njazi Zate
5233	784	Hysen Velmishi	7163	1147	Ndoc Kola	8187	784	Pjetër Rasha	9394	1699	Illa Minella	10782	707	Frok Sadiku	12488	1147	Imër Bardhoshi
5241	784	Ndoc Rama	7167	707	Sadiq Balaj	8225	707	Dalip Bago	9420	1699	Tofik Memushaj	10784	707	Aziz Kaloshi	12489	707	Muharrem Kasmi
5254	784	Haxhi Demira	7168	1699	Shefki Sulke	8236	784	Zenel Bupçapa	9424	1699	Malo Rrapi	10813	784	Islam Bami	12490	1699	Shaban Gashi
5270	1147	Flora Vila (Shyti)	7172	1699	Vendi Bicaku	8237	1699	Hasan Xhehi	9425	1699	Leofik Bevi	10817	1699	Hysni Shehu	12491	1699	Pjetër Llesjab
5289	707	Zef Lleshi	7176	707	Zenel Sinanaj	8239	1147	Amir Lama	9445	1699	Namik Hydi	10839	1699	Abdulla Sinani	12520	707	Jorgji Robo
5293	1699	Ahmet Hotaj	7187	1699	Ejup Dajçi	8242	1699	Edi Kapshica	9450	707	Fatos Xhaferi	10842	1699	Adem Meniku	12530	784	Tomor Ypi
5295	707	Neshet Hamutaj	7190	1147	Mezan Muhtar	8251	1699	Jorgji Budo	9462	784	Sarandi Lula (Lulo)	10850	784	Rexhep Budo	12536	784	Abdi Deliallisi
5310	1699	Ruzhdi Ibi	7193	1699	Hali Bami	8254	707	Ndrec Çupi	9470	1231	Sul Dema	10858	707	Andrea Gjini	12539	707	Sytki Toprani
5317	1699	Gani Kasaj	7198	784	Jordij Thaçi	8258	707	Irfan Majuni	9471	784	Pjeter Karagozi	10871	1231	Besnik Duro	12540	1699	Hali Nezir
5319	1699	Abedin Destani	7227	1699	Georgje Papas	8260	707	Zdril Kuci	9483	1699	Petar Tati	10872	1699	Amzara Muço	12541	1699	Daniel Levis
5321	707	Mahir Berberi	7228	707	Jorgji Zguri	8297	784	Ali Sinomataj	9485	1699	Pjeter Saraci	10880	1699	Qamil Cota	12542	784	Kosta Menka
5325	1699	Gjetë Margjini	7234	1699	Sotir Rusta	8314	707	Pjeter Deda	9494	1699	Leonard Mihali	10881	1699	Shefqet Ali	12543	784	Dhimo Boci
5326	1147	Durro Ymeri	7239	1699	Ligor Papas	8317	707	Malo Hoxhaj	9509	1699	Xhavit Biçaku	10885	1699	Qamil Belba	12544	707	Zejnep Hysenbegasi
5327	1699	Hasan Shyti	7244	707	Preng Lleshi	8322	784	Ndrec Shoferi	9514	1699	Fadil Izeti	10902	1259	Selami Deliallisi	12545	707	Namik Hysenbegasi
5335	1699	Shaban Plaka	7247	1699	Sali Atjani	8323	784	Kol Tota	9515	784	Kostandin Tashko	10906	1147	Alkan Kanina	12546	784	Falk Gjoçaj
5336	1699	Ibrahim Plaka	7278	1147	Lazer Sokoli	8324	707	Zden Kozl	9519	1231	Selim Hasimja	10959	1231	Ymer Zoloshnja	12547	784	Ali Myftari
5337	784	Qemal Qytyku	7280	1147	Nikoll Pellumbaj	8333	1699	Brahim Vuçaj	9523	1699	Zylyf Lacka	10965	784	Qemal Jashtaj	12548	1147	Vasil Kati
5341	1699	Jani Papa	7282	784	Galip Sojli	8335	707	Ndrec Moli	9524	1699	Gago Thoma	10981	1259	Eqrem (Eqerem)	12549	784	Qani Çollaku
5342	1231	Xhemal Nežaj	7294	1699	Martin Margilaj	8336	1699	Gjelosh Grishaj	9525	707	Shaban Ponari	10982	1699	Agolli	12550	784	Hito Çakaj
5343	784	Teodor Gërmir	7303	1699	Hajri Mane	8341	1699	Gelo Zharkalli	9538	1699	Muço Cobo	10986	1699	Sali Guri	12551	1699	Kristofor Kallapodhi
5348	1699	Sheraf Gëlbrea	7308	784	Stavri Ruvina	8342	1699	Osman Xhehi	9539	1699	Sulo Malaj	10992	784	Pajazit Kaloshi	12552	784	Muharrem Bajaz
5355	1699	Nikoll Ndreca	7315	784	Grigor Liaboviti	8343	1699	Selam Lutaj	9584	1699	Osman Zuna	10993	707	Mehdi Muda	12553	1699	Jakup Babalul
5356	1699	Pjeter Çoku	7319	1699	Feim Strataj	8346	784	Muhamet Tepelija	9593	1699	Miftar Jegeni	11005	707	Fadil Uba	12554	784	Abdi Kalaj
5358	1699	Pal Çoku	7337	707	Zoran Norja	8377	784	Ahmet Kurshaj	9596	707	Illa Stavro	11011	707	Hasan Smajli	12555	1699	Sabri Ndreu
5360	1699	Fahri Malushi	7340	1699	Rufan Ndreu	8383	707	Xhabir Mustafaj (Gos-tivari)	9605	707	Ali Nežaj	11016	1699	Namik Beqaj	12556	1231	Nuri Dymushaj
5362	1699	Llesh Tomaj	7347	1699	Arif Kaci	8385	784	Mit'hat Myftiu	9626	707	Xhavit Hasanaj	11017	1699	Asri Hobdari	12557	1699	Petrit Hoxhaj
5363	1699	Petro Noto	7348	1259	Myrjet Dervishi	8385	784	Dhimitër Gjika	9634	784	Isuf Kurti	11019	1699	Bist Nikoll	12558	784	Ermin Gjura
5365	1699	Kadri Sinamati	7361	1699	Gjon Pergega	8387	707	Hivzi Gollja	9666	707	Hamit Halili	11021	1699	Selam Skajoti	12559	784	Franë Duci
5367	1699	Pano Priftaj	7362	1699	Dino (Farodin) Tomori	8397	1147	Rushit Copoli	9669	1699	Ejup Kurtulla	11030	1259	Sinun Petrela	12560	707	Xhafer Zoti
5371	784	Fadil Lami	7372	1699	Rexhep Xhika	8398	1699	Rushit Copoli	9697	1699	Kol Sylaj	11041	707	Zef Deda	12561	707	Nuri Dymushaj
5402	707	Myslym Rinxhi	7377	1699	Osman Pepparku	8403	1147	Naim Lipo	9719	1699	Falk Tahiraj	11050	1699	Kozma Dadolli	12562	1231	Petrit Hoxhaj
5403	784	Arshad Vata	7384	784	Lazer Sokoli	8405	784	Egrem Belu	9734	784	Plamur Xhuli	11064	784	Amza Ramazaj	12563	784	Dule Bamshaj
5406	1699	Riza Hoxha	7381	784	Rok Metaj	8418	1699	S a b r i	9736	1259	Uke Avdiqaj	11085	1699	Kremet Mersini	12564	784	Fane Kallushi
5411	707	Ferrik Hysenaj	7385	784	Qazim Zebi	8431	1699	Kapollari(kapa)	9743	784	Ibrahim Behra	11119	707	Hasan Graceni	12565	707	Rexhep Meta
5412	1699	Muharem Ahmatas	7390	707	Vangjel Zaho	8437	707	Fadil Plumbi (Hafzi, Aseja)	9748	707	Velj Mulla	11122	707	Avdi Gollja	12566	784	Napolon Kalcia
5413	1699	Sotirax Tase	7393	784	Prend Frrroku	8438	1147	Enver Pacrami	9750	707	Sulejman Mulla	11143	707	Behar Polovina	12567	1231	Jaflja Kuraj
5414	707	Preng Gjoni	7426	1699	Ivni Kokaçi	8458	784	Enver Pacrami	9750	707	Muharem Rrenjollari	11145	784	Riza Kamjari	12568	784	Andon Kolaci
5415	707	Pashko Gjeçi	7429	784	Bexhet Daci	8457	1699	Hasan Spahiu	9796	1699	Leht Lleshi	11158	784	Mustafa Greblleshi	12569	1699	Burim Kokoshi
5416	784	Agron Dudushi	7444	1699	Demirsha Qosja	8462	784	Rrahman Kuti	9797	1699	Ahmed Lusha	11172	1699	Marko Katro	12570	784	Shaqir Troshani
5428	707	Rakip Nerguti	7445	1699	Koço Gjini	8465	1699	Neim Sallaj	9804	707	Shefki Spata	11173	1699	Pjetraq Katro	12571	784	Kolë Peja
5432	1699	Sadri Ahmeti	7466	784	Gjon Maka	8484	1699	Vajo Telio	9806	707	Illa Tarusha	11174	1699	Kristaq Ristani	12572	784	Kolë Peja
5433	1699	Shahin Zeneli	7467	1699	Arif Çupi	8485	1699	Osman Dudaçi	9826	707	Edi Beqaj	11180	707	Arif Hoxhaj	12573	784	Enver Kalcia
5434	1147	Isa Abdija	7504	1699	Qerim Gumbardhi	8497	1699	Tomor Zotbejas	9836	1699	Apotim Mosko	11191	1147	Med Lleshaj	12574	784	Kristaq Çervishi
5440	784	Sait Corapi	7513	784	Atif Merdani	8522	1699	Niazi Gorica	9840	1699	Vladimir Dhora	11193	707	Myshin Muka	12575	784	Shaqir Sta
5445	1699	Shygyri Rubiku	7526	1699	Xhecur Zambaj	8525	1699	Aleks Cemi	9841	1699	Shqip Çejvani	11253	707	Nam Sylaj	12576	784	Prerit Tusha
5456	784	Qerim Selmani	7529	707	Keuran Sejdaras	8526	707	Vilas(Vasil) Dhaskali	9852	1147	Kajmak Bardhollari	11257	1699	Edison Gjergo	12577	784	Ram Tusha
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531	784	Hali Haxhija	9862	707	Gjergji Beleshi	11273	784	Bajram Totrakaj	12578	784	Arif Hoxhaj
5459	1699	Qazim Haçkoviç	7557	784	Bektaş Levenishi	8531											

SHKRIMTARET DIKTATURA

Së shpejti libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët nën diktatin komunist", i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

Zbulohet korrespondenca e vitit 1974 e sekretarit të Enverit, Haxhi Kroj

Kur Koço Danaj detyroi Enverin të ndalonte filmin italian "Gruaja më e bukur"?!

Dokumenti: Si argumentonte oficeri i ri i Kufirit, ndalimin e filmave, "Rrëfimet e komisarit të policisë", "Shën Tereza dhe djajtë"...



Enver Hoxha dhe Hysni Kapo

Nga Dashnor Kaloçi

Brezi i shqiptarëve që kanë qenë në moshë të rritur në fillimin e viteve '70-të e kujtojnë fare mirë se si thyeshin sportelet e biletave dhe dyert e kinemave në mbarë vendin kur shfaqeshin filma të huaj, si p.sh. ato të regjisorit të famshëm italian, Damiano Damiani, "Gruaja më e bukur" (La moglie più bella) të interpretuar nga aktorja Ornella Muti, (asokohe 14 vjeçare) në rolin e Françeska Çimarozës dhe Alesio Orano në rolin e Vito Juvares, apo "Rrëfimet e Komisarit të Policisë", ku rolin kryesor e interpretonte i madhi Franko Nero, (dhe në role të tjera, Martin Balzam e Mariku Toro), filma të cilat bënë një bujë të madhe dhe u pritën me një interes të jashtëzakonshëm nga publiku artdashës shqiptar edhe për faktin se në qendër të filmit ishte mafia italiane e asaj kohe. Por shkëlqimi i këtyre filmave nuk zgjati shumë dhe u venit shpejt, pasi papritur aty nga fundi i vitit 1974, si me magji, ato u zhdrukën përgjithmonë nga qarkullimi për të mos u shfaqur më kurë në kinematë shqiptare, ku bashkë me sportin, pothuaj ishin të vetmet argëtime apo më saktë "frëngjitë" e vogla nga ku mund të shikohej pak bota e jashtme nga ai realitet i izoluar dhe mbyllja në të cilën e kishite futur vendin udhëheqja e lartë komuniste me në krye Enver Hoxhën. Edhe pse në vitet që pasuan regjisorit i famshëm italian me përmasa botërore, Damiano Damiani, do të ishte përsëri "mysafir" në Shqipërinë komuniste me film-in "La Piovra" të interpretuar në rolin kryesor nga aktori i jashtëzakonshëm, Mikele Placido, filmat e tij "Gruaja më e bukur" dhe "Rrëfimet e komisarit të policisë" do të mbeteshin si një kujtim i bukur i së shkuarës dhe në memorien e të rinjve të asaj kohe nuk do të fshiheshin lehtë portretet e aktorëve Ornella Muti, Alesio Orano, Franko Nero etj. Po ç'kishte ndodhur me këta filma dhe



Regjisorit i famshëm italian, Damiano Damiani

përse ata nuk u shfaqën më në kinematë shqiptare ku vazhdohej të bëhej "rituali" me filma të huaja dhe ata italian gjithashtu?! Të vërtetën e kësaj, pra të ndalimit të dy filmave të Damianit që asokohe po shkëlqente me mjeshtrërinë e tij në Europën e uritur për kinemanë italiane, as sot e kësaj dite nuk e di njeri, pasi, pothuaj të gjithë ata që morën vendimin për ndal-

imin e atyre filmave, tashmë prej vitesh janë ndarë nga kjo jetë. Por për fat të mirë, i vetmi dëshmitar që jeton ende, është pikërisht personazhi që u bë shkas, apo më saktë ai që i "zhduku" ato dy filma nga qarkullimi, dhe bashkë me to edhe filmin rumun "Shën Tereza dhe djajtë", (të regjisorit të famshëm, Serxhu Nikolaesku ku rolin kryesor e interpretonte, aktorja, Reka

Nagi, nga pakicat e minoritetit hungarez), filmin televiziv serial, prodhim çekoslovak, "Kapiteni Klos", (titulli origjinal, "Cmimi më i lartë se jeta"), si dhe disa libra "të verdhë" si "Qeni i verdhë" (i autorit Zhorzh Simeon), etj. Ai është Koço Danaj, me origjinë nga Tepelena, personazh publik mjaft i njohur pas viteve 90-të si publicist e studiues, por edhe i mjediseve politike si kryetar i një partie të vogël, i cili në vitin 1974 kur shërbente si oficer për Kufirin (sekretar rinie), në Degën e Punëve të Brendshme të Shkodrës, dhe njëkohësisht anëtar i Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, i dërgoi një letër Haxhi Kroit, sekretarit të Enver Hoxhës, ku i kërkonte ndalimin e filmave dhe librave të sipërcituar. I diplomuar atë vit në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës, njohës i disa gjuhëve të huaja dhe me një formim e bagazh kulturor për t'u pasur zili, (kryesisht për njohuritë e tij në letërsinë dhe kinematografinë botërore), por edhe i indoktrinuar jashtë mase, në letërnë e tij dërguar në adresë të kabinetit të Enver Hoxhës, Koço Danaj, ka analizuar me detaje se përse ato filma dhe libra nuk kishin vend në Shqipërinë Socialiste. Pra sa më sipër, duket se nuk ishte vetëm regjimi komunist me institucionet përkatëse të propagandës që "i bënin sytë katër" për të mos "depërtuar ideologjia e huaj" në Shqipërinë Socialiste, por "roje vigjilente" bënin edhe individë të veçantë, si në rastin në fjalë, që nuk e kishin atë gjë detyrë funksionale. Dhe si rezultat, duket se letra e oficerit të ri, Danaj, asokohe "ka zënë vend", pasi filmat dhe librat që ai "sugjeron" të ndaloheshin, jo vetëm u hoqën nga qarkullimi, por disa institucione që i kishin ato në varësi, si Kinostudio "Shqipëria e re", "Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" apo Radio-Televizioni Shqiptar, patën mjaft probleme sepse i kishin lejuar apo hedhur ato në qarkullim. Jo vetëm kaq,

por letra e oficerit të ri të Kufirit ishte e "kopsitur" aq "hollë", sa vuiri në siklet edhe vetë udhëheqjen e lartë të PPSH-së së asaj kohe, si Hysni Kapon, Piro Kondin, etj., saqë nuk dinin se si, ku dhe çfarë përgjigje t'i jepnin atij si autor i saj?! Interesant është fakti se përse ajo letër nga kabineti i Enver Hoxhës nuk i është dërguar për "shqyrtim" Ramiz Alisë që mbulonte artin, kulturën dhe propagandën, por Hysni Kapos, i cili mbulonte organet e "Diktaturës së Proletariatit"? Lidhur me këto e të tjera, na njeh letra në fjalë që publikohet e plotë dhe për herë të parë në faqet e këtij libri e, gjithashtu, ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare".

LETRA E KOÇO DANAJ PËR SEKRETARIN E ENVERIT, HAXHI KROI (DOSJE SEKRETE)

Shoku Haxhi Kroj

Po ju drejtoj këtë letër dhe jam nisur nga dy qëllime, ndoshta mund t'i shërbej sado pak Partisë dhe së dyti për të sqaruar veten.

Problemi që dua të sqaroj ka të bëjë lidhur me zbatimin në praktikë të fjalimit të shokut Enver të 15 marsit dhe të Plenumit të 4-të. Konkretisht e kam fjalën për disa filma që janë shfaqur në ekranet e kinemave dhe të televizionit tonë, si dhe për disa libra të përkthyer.

Me aq sa i kam kuptuar unë mësimet e Partisë dhe të shokut Enver, veçanërisht mbi presionin e gjithanshëm ideologjik borgjezo-revizionist, më duket se këta filma e këto libra për ne janë të dëmshëm, por nga bisedat që kam bërë me shokët dhe me njerëz të rritur, një pjesë e mirë e tyre ma kanë quajtur mendim të gabuar. Për këtë arsye unë nuk jam shumë i qartë dhe nuk diç kam gabim apo të drejtë.

Po mendohej shkurtimisht t'ua tregoj, ashtu siç kuptoj unë, disa nga idetë e disa filmave për të cilët mendoj se janë të dëmshëm për ne dhe dëshiroj që po të ketë mundësi Partia të më sqarojë çfarë kam gabim e çfarë kam


të drejtë.

Filmi "Shën Tereza dhe djajtë" është një film me anë të cilit autorët mundohet të na japin një aspekt nga lufta e popullit rumun kundër fashistëve gjermanë dhe më konkretisht episodin e shkatërrimit të një ure. Mbas zhvillimit të aksionit partizanët që hodhën në erë urën, vriten. E gjithë kjo është plotësisht e justifikueshme, por mënyrat dhe detajet që zgjedhin autorët për realizimin e një ngjarje të tillë janë të papranueshme. Duke njohur mendimet e klasike të marksizëm-leninizmit dhe historinë e Luftës Nacional-Çlirimtare të udhëhequr nga Partia jonë, mendoj se idetë e këtij filmi bien në kundërshtim të plotë me përfytyrimin tonë mbi Luftën Nacional-Çlirimtare. Cilat janë gabimet ideologjike të filmit, duke u nisur nga pozitat e ideologjisë marksiste-leniniste?

Së pari, populli ynë ka një fjalë të urtë që thotë "Mos shiko vetëm kur derdhet lumi, por shiko edhe ku dredhon ai". Filmi nis me një fatkeqësi të njeriut prej heronjëve, e shkakuar kjo nga dy kuajt të bardhë, e cila në fund të filmit shëndrohet në realitet.

Së dyti, morali i partizanëve dhe i partizaneve tona gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare ishte një moral i pastër dhe, duke qenë i tillë, bëri pluhur e hi parrullat reaksionare të Ballit Kombëtar dhe zagarëve të tij mbi moralin e komunistëve, kurse në këtë film me temë nga lufta, me anë të disa skemave plot nudizëm, na dalin përpara sysh aventurat dashurore të dy "komunistëve".

Së treti, simbas mësimëve të Partisë sonë, ne e dimë se ata që ranë për atdheun cimentuan me gjakun e tyre këtë kështjellë të socializmit që po të shikojmë sot. Për këtë arsye të gjithë ne u përkulemi me venera-



Dosja Sekrete

cion atyre dhe i mbajmë gjithmonë në zëmrat tona. Kurse në film ndodh e kundërta, një grup të rinjsh rumun "një grup qejflinjsh", vijnë tek varri i pesë partizanëve dhe njëri prej tyre thotë se: këtu më duket se kanë rënë im atë?! Kurse mbi varr qëndron me e varur një copë dërrasë?! (ndërsa lapidarët e dëshmorëve tanë sulmojnë qëllimllë). Mund të lindi një pyetje: Ç'të keqe ka këtu? Spektatori ynë e sheh në mënyrë kritike një film të tillë duke e ndarë në një anën grurin nga egra? Kjo është shumë e drejtë, por një film i tillë s'ka aspak grurë përvec egrisë. E dyta autorët e filmit, për mendimin tim, e kanë parashikuar një gjë të tillë dhe e kanë futur në rrjedhën e ngjarjeve një "ilegal" shumë tërheqës që s'ka frikë të nxjerri në pah format e trupit, si dhe disa skena të poshtra me udhëheqësin e aksionit, edhe ky "komunist". Këto autorët e filmit i kanë futur që të mos i lënë kohë spektatorit të gjykojë mbi idetë e tyre, por t'i trullojnë atij mendjen që t'i thihet këto ide pa i kuptuar.

Për këto arsye dhe duke u nisur nga lufta që i bëjnë partia për të kalitur ideologjikisht njeriun tonë në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist, mendoj se se shfaqja e këtij filmi më shumë prish punë se ndreq punë. Në një kohë kur Partia i ka dhënë grushte dërmuese fesë, këtij "opjumi" kësaj "zemre të një

socialiste apo borgjez-revizioniste dhe me që ideologjia marksiste-leniniste nuk ka hyrë plotësisht në ndërgjegjen e shumë njerëzve, përse ta mbushin këtë boshllëk me ide të tilla që mund t'u vësh çfardo lloj emri, veç jo marksist leniniste?

"Gruaja më e bukur" është një film italian që trajton një temë sociale. Me anë të këtij filmi autorët mundohen t'u mbushin mendjen njerëzve për të kundërtën e asaj që ndodh në kapitalizëm, mundohen ta paraqitin jetën jo siç është në të vërtetë, por siç i intereson borgjezisë monopoliste. Sipas pikpamjes së Partisë sonë, në kushtet e ashpërsimit të luftës së klasave dhe në kushtet e një krize të përgjithëshme ekonomiko-sociale, borgjezia mundohet ta zhdukë çdo liri demokratike, merr çdo masë për të ruajtur të pacënuar rendin e saj. Të gjitha predikimet e apologetëve të saj mbi harmoninë e këtij rendi, mbi mirëqenien dhe liritë e mëdha që gëzon individit, janë krejt falco. Në veprën e shokut Enver "Raportet dhe fjalime" të viteve 1967-1968, faqe 134, thuhet kështu: "Në regjimet kapitalisto-revizioniste apanecant e lirisë janë të gënjeshërta, gjoja modernizat duan të tregojnë atë që në realitet nuk ekziston aspak, lirinë e individit, çlirinë e gruas nga zgjedha kapitaliste dhe ndjenjat e pas-tras".

Shtrohet pyetja: A ka çfarë të mësojë spektatori ynë nga ky film? Po, ka, por më shumë gjëra negative se pozitive. E them këtë sepse në disa filma dhe romane të përkthitura ndodh ashtu siç thotë Partia jonë që: armiku e fut helmën e tij pa u ndërë, pa të mos thënë se ky është helm, por të shoqëruar dhe me disa anë pozitive. Gjithë filmi vërtitet rreth "dashurisë" që ushqen një borgjez i fuqishëm për një vajzë dhe për luftën që bëjnë vajza deri sa e fut në burg, duke patur edhe përkrahjen e policisë?! E ishte interesant fakti se gjithmonë sa herë ata mundohen ta fusin helmën e tyre, këtë e shoqërojnë me artiste të bukura dhe me një frazeologji të kulluar. Autorët e filmit mundohen t'u mbushin mendjen njerëzve se, në bazë të martesës në vendet kapitaliste, qëndron dashuria dhe ndjenjat e pas-tras, por sipas pikpamjeve të marksizëm-leninizmit në kapitalizëm në bazë të martesës qëndron levdërdia dhe jo dashuria. Në këtë shoqëri dashuria dhe ndjenjat vihen në shërbim të pronës private. Duke e zhvilluar më tej këtë pikpamje, shoku Enver nën vizion se, megjithëse martesë është një akt shoqëror, në fund të fundit ka filozofinë e saj si në rendin borgjez, ashtu dhe në atë socialist. "Në bazë të kësaj martesë (martesës borgjeze), nuk qëndrojnë në fakt ndjenjat e pas-tras, por ndjenjat e egra të pronës dhe të interesit privat të pasurisë, të trashëgimisë, të kurvërisë së burrit dhe të gruas".

Së dyti, autorët e filmit mundohen t'i mbushin mendjen spektatorit se fem-

ra në shoqërinë borgjeze gëzon të gjitha të drejtat, duke na paraqitur një femër "trime dhe të emnacuuar" që lufton kundër padrejtësive dhe fut në burg ish të dashurin e saj. Edhe kjo ide bie në kundërshtim të plotë me atë që ndodh në realitetin borgjez. Sipas marksizëm-leninizmit në qoftë se ka qenie më të përbuzur e më të ulët në shoqërinë kapitaliste dhe pikërisht atë institucionin fetar, në vlerimin për gruan del qartë se çfarë roli i takon gruas në këtë shoqëri "skllave e zotit në qiell, e padronit në tokë, e burrit në shtëpi". Ja një nga vlersimet e panumërta të fesë mbi gruan. Në raportet dhe fjalime të vitit 1967-1968, shoku Enver midis të tjerash thotë se: "qoftë në kohën e Rilindjes apo në kohën moderne dhe gjoja qytetërimin e rafinuar", kontemporan borgjez, gruaja ka qenë dhe është krijesa njerzore më e skllavëruar, më e shtypura, më e përbuzura nga çdo pikpamje".

Së treti, autorët e filmit na e paraqesin policinë shumë demokratike që përpigjet dhe interesohet për të gjithë njësoj. Një ide e tillë e ka burimin tek predikimet e teoricienëve borgjezë mbi "shtetin e miqërisë së përgjithëshme, mbi shtetin si organ jashtë klasave". Sipas marksizëm-leninizmit të gjithë këta njerëz s'janë veçse "çirakë" me diplomë në shërbim të borgjezisë", kulla të saj që ajo i ndërron sa herë që s'shërbejnë mirë. Një gjë e

tillë bëhet më bindese nga fakti se në atë vënd ku fillojnë e ringjallen forcat më të errta, siç janë neofashistët italianë, në atë vënd është e pamundur të ketë liri të tilla për të cilat flasin aq shumë shërbëtorët e borgjezisë.

Disa kohë më parë në ekranin e televizionit tonë u çfaq një film çekosllavak me temë nga lufta e popullit çek kundër okupatorit gjerman. Nga të gjitha episode që ka filmi, si dhe nga vetë fundi i tij, mendoj se ky film është kryekëput revizionist. Përse? Mbase mbaron së shikuari filmin, për mendimin tim, nxjerr dy ide që mundohen të thonë autorët. Ideja e parë është kjo: "njerëz, mos luftoni, se shkoni që lufta është e tmerrshme". Ideja e dytë "mos u mundo me kot t'i rezistosh Gestapos, rezistenca më e mirë që mund të bësh është t'i japësh fund jetës, s'kanë rëndësi bindjet e tua, qofsh komunist apo çfardo tjetër, vrit veten që të shpëtosh nga torturat".

Po mundohem shkurtimisht që ta bëj më të qartë. Gestapua kap një komunist çek dhe disa strehues të tij. Ndërsa Gestapua pyet komunistin, në një dhomë qëndronte një gjojtinë e tmerrshme, që filloi t'i priste kokat njerëzve. Komunisti çek, "duke mos duruar dot tërëngjllimin e saj që shërbente dhe si një

paralajmërim për të, pret venat e duarve dhe vdes. Më duket se ky është heroizëm. Në film nuk ndihet fare ajo rezistençë që bëri populli çek, mungon ana tjetër e luftës, ideat dhe qëllimet e larta në emër të cilave revolucionarët dhanë jetën në atë luftë. Ideja e autorëve dhe e "komunistit" çek është diametralisht e kundërt me idenë dhe qëndimet e Julius Fuçikut e përmbledhur në thënien "Njerëz, ju kam dashur, jini vigjilentë".

A nuk provuan nazistët gjermanë, me Hauzdingun në krye, në trupin e Manush Alimanit torturat çnjerzore që ekzistonin deri atëherë? I provuan që të gjitha, por ai duroi sepse kish një ideal, një qëllim të lartë, kish mësimet e Partisë Komuniste Shqiptare që e çmendën xhelatin e Gestapos. Manush Alimani nuk preu venat e duarve, por belëzonte gjatë çdo torture fjalët e zarrta "Plastë hasmi e u tërboftë, për jetë Partia rroftë". Pra tjetër përfytyrim krijon njeriu ynë duke njohur Luftën Nacionalçlirimtare dhe tjetër duke parë një film të tillë. Një film që të ngjeth, një film me ide të poshtra, një film që të ngjall pesimizëm dhe pafuqi kundër okupatorit, një film që ëpredikon nënshtrimin dhe robërinë është krejt i dëmshëm për spektatorin tonë. (vijon nesër)

PJESËMARRJA E DREJTPËRDREJTË GJIMNAZISTËVE NË VENDMARRJEN E QEVERISJES VENDORE NË DOMOSDOSHMËRI EDHE PËR VENDIN TONË.

Niveli i lartë ekonomik-shoqëror dhe kulturor i vendeve më të zhvilluara europiane kërkon jo vetëm një qeverisje të aftë dhe të përgjegjshme, por edhe një shoqëri të ndërgjegjshur dhe të ndjeshme ndaj problemeve të vendit të saj shoqëror e cila mban në vetente formimin e nevojshëm për pjesëmarrje në të gjitha nivelet e qeverisjes të mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të vazhdueshme. Kështu veprohet për shembull në Zvicër e cila e konsideron këtë pozicionin frytëdhënës të shoqërisë, të domosdoshëm jo vetëm për vendin e saj, por edhe për vendet më pak të zhvilluara europiane apo edhe ato në tranzicion.

Shtë kjo arsyeja që Qeveria Zvicëriane nëpërmjet ambasadës së saj në vendin tonë ka ofruar mbështetje me anën fondeve të saj për Shqipërinë fundi i cili administronhet nga Organizata LEVIZABANIA me anën e koordinimit të veprimtarive në këtë fushë.

Në Ligjin nr. 139 "Për Qeverisjen Vendore" neni 23 që bën fjalë për "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike", thuhet se "Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e jurisdikcionit të tyre (pika 11). Ndërtimin, reabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.

Në përputhje me këtë ligj në menduam të marim përsipër advokimin e nxënësve të arsimt parauniversitar për ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e përfshirjes në aksionin qytetar për pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë në vendimarrjen e qeverisjen vendore lidhur me miradiministrimin e infrastrukturës në shkollat e tyre.

Qëllimi i projektit është fuqizimi i aftësive advokuese të nxënësve për evidencimin dhe zgjidhjen e problemeve të infrastrukturës në shkollat e Njësisë Bashkiake Nr.5, Veprimtarisë e parashikuar në këtë projekt u zhvillua në shkollat e arsimt parauniversitar, "Petro Nini Luarasi", "Besnik Sykja" dhe "Arben Broci".

Objektivat përfshijnë: 1. Identifikimin e të rinjve të motivuar dhe aftësitimin e tyre në evidencimin e problemeve të infrastrukturës në shkollat përkatëse duke formuar edhe grupe informale të komunitetit me senatorë, nxënës, prindër dhe mësues. 2. Fuqizimi i grupeve informale me në qendër nxënësit dhe kapacitetet e tyre advokuese nëpërmjet veprimt të tyre në terren duke ndjekur problemet dhe diskutuar vendimarrjen për zgjidhjen e tyre. 3. Monitorimi i punës së shkollave, Njësisë Bashkiake Nr.5, Bashkisë Tiranë duke angazhuar grupet e punës përmes aktivizmit, veprimtarive on-line dhe ndjekjes administrative të problemit.

U punua me strukturat rinore (senatet e Kla-

sive dhe të shkollës) dhe drejtoritë e shkollave lidhur me problemet dhe mangësitë në infrastrukturën e shkollës, komunikimin me njësinë vendore si dhe me menyrën e përfshirjes direkte të gjimnazistëve në vendimarrje. Kërkesat e nxënësve të tre gjimnazëve u identifikuan përmes pyetësorëve të plotësuar edhe tyre, nga të cilët 229 meshkuj dhe 126 femra si dhe komiteti i prindërve.

Aksioni qytetar u planifikua në tre faza në bazë të rrugëzimit të problemeve të ngritura dhe propozimeve të hartuara nga grupet e punës në çdo shkollë:

1. Probleme që do të zgjidhen menjëherë.
2. Probleme që kërkojnë ndërhyrje të specializuar apo përcaktimin e artificeve për t'i realizuar sa më parë.
3. Probleme që do të zgjidhen në vitin 2019 duke hyrë në procedurat normale të planifikimit për buxhetin e vitit 2019.

Rëndësi e veçantë u kushtua pasqyrimit të projektit të këtij aksioni rinor në median vizive dhe sociale ku e realizua edhe një spot publicitar lidhur me aksionin. U hap faqe në Facebook dhe Instagram duke përdorur logon e projektit PNXV (Pjesëmarrja e nxënësve në Vendimarrjen e qeverisjen vendore). Për vitin 2019 senatorët së bashku me specialistët e bashkisë hartuan projektin tip dhe janë senatorët ata që do të ndjekin marrëdhëniet ndërmjet shkollës, komunitetit dhe bashkisë. Ata do të jenë mbështetja kryesore e aksionit dhe së bashku me individë të zgjedhur duhet që njohuritë e përfitura t'ia transmetojnë gjithë nxënësve të (jerë në klasë dhe shkollë me qëllim pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë në vendimarrje dhe nëpërmjet antëntërsimit tek faqja "Tirana ime" ose "Me ty për Shqipërië që duam" ata mund të shfrytëzojnë mundësinë për t'u përfshirë në diskutime të brendshme të bashkëqeverisjes ose aktivitetet të ndryshme qeveritare.

Në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, e cila jo vetëm e ka mirëpritur projektin, por edhe mbështetur atë, u zgjidhën problemet të cilat u përcaktuan si të menjëhershme si dhe u ra dakort për dhëniein rrugë të problemeve që kërkojnë ndërhyrje të specializuar dhe atyre që kërkojnë më shumë fonde, për t'u parashikuar në buxhetin e vitit 2019.

E rëndësishme për t'u theksuar është ndërgjegjësimi i nxënësve, prindërve dhe mësuesve në evidencimin e problemeve të infrastrukturës së shkollës së tyre dhe ndërgjegjësimi të tyre për të ndjekur këtë rrugë edhe në të ardhmen, duke e ndërjer veten të përfshirë drejtëpërdrejtë në vendimarrjen e qeverisjes vendore për këto probleme.

Mendojmë se një iniciativë e tillë duhet shtrirë në të gjitha shkollat e vendit, por edhe në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Niko Terezi

Dedë Lufaj qëllloi me armë ndaj tre vetëve në Vuksanaj

Kapet i dënuari me 16 vite burg për vrasje të mbetur në tentativë

Një 48-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Shkodrës, pasi ishte dënuar me 16 vite burg për "Vrasje me paramendim e mbetur në tentativë" e "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit". Burime zyrtare thanë se bëhet fjalë për Dedë Lufaj, banues në fshatin Vuksanaj. Ndalimi i Lufajt u bë pasi Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, më datë 18.02.2016 ka lënë në fuqi vendim e Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila e ka dënuar këtë shtetas me 16 vite burg për veprën penale "Vrasje me paramendim e mbetur në tentativë" e "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit". Ky shtetas me datë 4 korrik të 2014-ës në lagjen Dedaj, fshati Vuksanaj-Shalë ka qëlluar me armë zjarri automatik në drejtim të shtetasve N. L., Z. L. dhe Sh. L. Materialet u referuan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprime të mëtejshme.



Përplasje e qëllimshme, kush është personi që porositi sherrin

TIRANE-Zbardhet ngjarja e ndodhur në Tiranë më datë 25 tetor, ku një 32-vjeçar përplasi qëllimisht me mjetin e tij një tjetër makinë, ndërsa më pas u konfliktua me shoferin duke përdorur armë zjarri. Ngjarja në fjalë ndodhi në Kamzë. Burime zyrtare nga policia pohuan se në pranga ra Elis Ademi, si dhe identifikua dhe u shpall në kërkim bashkëpunëtorin dhe porositi i kësaj ngjarjeje. Nga veprimet hetimore të kryera ka rezultuar se Ademi është paguar nga shtetasi S. C., për të dhunuar fizikisht shtetasin me inicialet I. Xh. Po ashtu mësohet se Ademi për kryerjen e kësaj porositje ditën e ngjarjes kishte marrë dhe shtetasin F. M., duke i premtuar një shumë monetare. Ndërkohë, policia ka shpallur në kërkim shtetasin me inicialet S. C., porosites i dhunimit fizik të I. Xh. si dhe shtetasin F. M., bashkëpunëtorin Ademi. Në vijim të veprimeve hetimore policia ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale armën e zjarrit të cilën shtetasi Elis Ademi pas ngjarjes e kishte hedhur në Qerek, në zonën e Fushë Krujës. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasit E. A., për veprat penale "Vrasja e mbetur në tentativë", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", "Shkatërrimi i pronës" dhe "Prishja e qetësisë publike".

Hyn për të vjedhur, por e ha keq, çfarë ndodhi në Durrës

Durrës-I hidhur ka qenë fati i një hajduti në Durrës, i cili teksa ka tentuar të vjedhë, ka rënë pre e dhunës. Ngjarja ndodhi në fshatin Jubë të Durrësit. Burime zyrtare nga policia thanë se shtetasi me inicialet F.K., kishte hyrë në lokalitë të një personi, ndërsa aty ishte përballur me nipin e

pronarit. Ky i fundit, Skënder Lisaku, 25 vjeç, ka tentuar të vrasë me mjete të forta duke goditur disa herë në kokë (me dru) hajdutin, ndërsa vet ka rënë në pranga. Ndërkohë, i riu që kishte hyrë për të vjedhur tashme po procedohet penalisht. Aktualisht shtetasi me inicialet F.K.

ndodhet në spitalin e Traumës Tiranë nën kujdesin e mjekëve. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprat penale "Vrasja me dashje" e mbetur në tentativë në ngarkim të Lisakut dhe "Vjedhja" e mbetur në tentativë.

SHKURT

Humb jetën në aksident i riu shqiptar


ITALI-Tragjik ka rezultuar fati i një 22-vjeçari shqiptar, i cili ka humbur jetën në një aksident tragjik në Reggio Emilia në Itali. Ngjarja e rëndë ndodhi sot rreth orës 7 të mëngjesit. Mediat italiane raportojnë se Ermaldo Zefi, po udhëtonte me makinën e tij tip 'Fiat 500', kur humbi kontrollin e mjetit duke dalë nga rruga dhe u përplas me një pemë. Po ashtu bëhet e ditur se fatkeqësisht 22-vjeçari ndërroi jetë në vend si pasojë e plagëve të rënda. Ndërkohë që policia po heton rreth zbardhjes së rrethanave të aksidentit.

Vidhte pajisje elektrike e kablo, prangoset

VLORE-Një 45-vjeçar ka rënë në prangat e policisë së Vlorës, pasi akuzohet për një sërë vjedhesh. Burime zyrtare thanë se në kuadër të operacionit të koduar "Salvavita" u kap Altin Beluli, banues në Vlorë. Beluli akuzohet se më datë 19 tetor të këtij viti në një pallat në ndërtim në lagjen "1 Maji" Vlorë, dyshohet se ka vjedhur pajisje elektrike në kutitë shpërndarëse të pallatit. Në kuadër të këtij operacioni, nga hetimet e kryera janë zbuluar dhe dokumentuar edhe 2 vjedhje të tjera në ngarkim të këtij shtetasi.

Pedagogë! E ardhmja nis në klasën tuaj.

Shëndeti juaj sigurohet me Cash Plan-in tonë!



SIGURIMI JETË dhe SHËNDET CASH PLAN

Të gjitha përfitimet në një zgjidhje, me sigurimin Jetë dhe Shëndet Cash Plan! Siguroni veten dhe familjen tuaj, duke filluar nga 85 euro në vit/person dhe përfitoni mbulim për ndërhyrje kirurgjikale, vizita, analiza, medikamente, etj. deri në 25,000 Euro/vit.

- Sigurim Jete
- Checkup mjekësor vjetor
- Mbulim të shpenzimeve shëndetësore
- Zbritje deri në 60% në spitalet dhe klinikat private pjesë të rrjetit mjekësor SiCRED




Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al

MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Vështirësitë në
tretje, kura me bimë
medicinale

KESHILLA



Ushqimet që
duhet të
konsumoni
gjatë menopauzës

Arben Rrugia:



◆ Drejtori i "Koço
Gliozhenit":
Pacientët nuk
informohen mbi
rrezikshmërinë
e SC-së

39 për qind e grave në Shqipëri i nënshtrohen lindjeve me operacion

"Obeziteti dhe mosha e
madhe, faktorët kryesorë"

• Përdorni hudhrën e kuqe kundër sëmundjeve tumorale. Efektet e mrekullueshme të kungullit në organizëm

Drejtori i "Koço Glliozhenit": Pacientët nuk informohen mbi rrezikshmërinë e SC-së

Arben Rrugia:

39% e grave në Shqipëri i nënshtrohen lindjeve me operacion

"Obeziteti dhe mosha e madhe, faktorët kryesorë"

Voltiza Duro

Kohët e fundit është vënë re një trend gjithmonë e në rritje i lindjeve me operacion. Sipas statistikave, në Shqipëri në vitin 2017, rreth 39% e lindjeve janë realizuar me SC, ndërkohë që OBSH rekomandon që numri i lindjeve të tilla të jetë jo më shumë se 15%. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", Arben Rrugia, gjinekolog dhe drejtor i maternitetit "Koço Glliozheni" tregon faktorët që ndikojnë në rritjen e numrit të lindjeve me operacion. Rrugia thekson se obeziteti, lindjet në moshë të madhe dhe vetë frika e pacienteve janë disa nga arsyt që gratë i drejtohen lindjeve SC.

Cfarë është lindja SC?

Trendi në rritje i lindjeve me operacion apo SC është fenomen tashmë mbarëbotëror, i pranishëm si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në vendet në zhvillim dhe aq më tepër në vendet e botës së tretë. Kjo rritje është e vazhdueshme, dhe është i pranishëm edhe në analizimin sipas variablave të ndryshëm të aplikuar në studime dhe metaanaliza të shumta që vlerësojnë këtë fenomen. Konkretisht trendi në rritje i lindjes me SC është i pranishëm në të gjitha grupmoshat amtare, ashtu si dhe në moshat e ndryshme të shtatzënisë (lindje premature, lindje në term apo lindje serotine), si dhe në përkatësi etnike.

Si paraqiten shifrat e këtyre lindjeve në vendin tonë?

Në Shqipëri përqindja e lindjeve me SC rezulton të jetë 39% (viti 2017), një përqindje e krahasueshme me vendet e rajonit si Italia, Maqedonia, ndërkohë që është mjaft më e ulët se ajo e Greqisë.

Rekomandimi i OBSH deri në vitin 2010 ka qenë që numri i lindjeve me SC të jetë jo më i madh se 15%, një shifër që është cituar shpesh nga politikëbërësit në lidhje me shqetësimin e krijuar nga rritja e përqindjes së SC në mbarë botën.

Cilat janë faktorët që ndikojnë në rritjen e SC-së?

Dikur mjeku nuk e rekomandon te rutinë lindjen me SC për shkak se kjo ndërhyrje konsiderohet e rrezikshme si për nënën dhe për bebin e saj, ndërkohë që me zhvillimin e teknikave operatore dhe instrumentimit si dhe zhvillimeve në fushën e anestezi-reanimacionit tashmë ky intervent nuk konsiderohet aq i rrezikshëm. Për më tepër lindja me SC e krahasuar me lindjen vaginale i ofron mjekut disa benefite, më kryesoret e të cilave janë kostoja kohore, siguria më e madhe për bebin dhe përfitimi ekonomik. Një prej arsyeve kryesore të rritjes së lindjes me SC është frika ndaj përbaljes me familjarin dhe me ligjin, duke qenë se lindja me SC

ofron më shumë siguri për mirëqenien e bebit. Mjekësia difensive që për fat të keq po aplikohet gjithnjë e më tepër në vendin tonë nxjerr në pah domosdoshmërinë e rishikimit të legjislacionit në lidhje me ushtrimin e profesionit të

mjekut si dhe politikat mbështetëse të drejtuesve të institucioneve mjekësore.

A ndikon obeziteti për lindjet me operacion?

Tashmë nuk është më risi që obeziteti është gjithnjë e më i pranishëm në pacientet obstetrikale. Për këtë arsye obeziteti ka peshën e vet specifike në rritjen e përqindjes së lindjeve me SC. Disa mjekë po akuzohen për rekomandim të pacienteve të tyre obeze për lindje me SC, por shpesh të këto nëna lindin me SC është një procedurë e nevojshme. Vitet e fundit po vihet re një rritje e pacienteve të cilat i nënshtrohen procedurave të riprodhimit të asistuar, rritje kjo që probabilitet mund të lidhet me moshën e nënës, mungesat hormonale apo arsye të tjera. Zakonisht këto paciente lindin me SC, (pavarësisht se nuk ekziston një indikacion real obstetrikal) me justifikim dhe të ashtuquajturit "fetusi i çmuar".

Gratë që bëhen nëna për herë të parë në moshë të madhe.

he, a janë të predispozuar për t'iu nënshtroar SC-së?

Gjithnjë e më shumë gra po bëhen nëna për herë të parë në moshë më të madhe, për shkak të karrierës, edukimit, në kuadër të 'Europianizimit' të shoqërisë. Pje-



Drejtori i "Koço Glliozhenit", Arben Rrugia

sa më e madhe e këtyre grave lindin me SC, probabilitet lidhur me problematikat në rritje të këtyre nënave të lidhura me moshën (hipertensioni, obeziteti, distocia, etj). Me zhvillimin e teknologjisë është rritur edhe aftësia monitoruese më e afërt e fetusit, e ashtuquajtur "mbikëqyrje më aktive". Ky monitorim mbart riskun e "medikalizimit" pra të mbivlerësimit të gjendjes së pasigurt fetale, me rezultat një numër më i madh lindjesh me SC. Problemet ligjore në kuadër të një monitorimi më të afërt fetal janë më agresive, sepse "Neglizhenca" konsiderohet më flagrante.

A informohen pacientet në lidhje me rrezikshmërinë e lindjeve me operacion?

Shumë prej pacienteve marrin vendimin për lindje me SC pa u informuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme me komplikacionet e mund.



shme të lindjes me SC si dhe alternativës së lindjes vaginale. Ka shumë prej tyre që mendojnë se risku është i njëjtë për të dyja procedurat (SC vs lindje vaginale). Për më tepër pacientet nuk informohen për vështirësinë në rritje në SC

pasardhëse. Edhe rënia drastike e lindjeve vaginale në prezantimet podalike ka impaktin e vet në përqindjen e lindjes me SC, për më tepër se pacientja do të lindte me SC edhe në shtatzënitë e tjera, pavarësisht prezantimit cefalik. Kjo i dedikohet mungesës së mjekëve "senior obstetër" të specializuar në pritjen e lindjes podalike si dhe me riskun e lindjes vaginale për bebin dhe pasojat ligjore të lidhura me këtë risk. Rritja e numrit të shtatzënieve multiple kryesisht prej shtimit të procedurave të riprodhimit të asistuar ndikon edhe kjo në rritjen e përqindjes së SC.

Lindjet SC janë një zgjidhje e vetë grave? Si paraqitet ky trend?

Diagnoza "Dëshirë e gruas" është gjithnjë e më e shpeshtë në rutinën e përditshme në lidhje me SC. Kjo i dedikohet frikës nga aktiviteti i lindjes vaginale, "komoditeti" të lindjes me SC, që shkon deri në atë nivel sa madje ka edhe gra të cilat kërkojnë lindje me SC edhe pasi kanë lindur më parë me rrugë vaginale. Vitet e fundit po aplikohet gjithnjë e më pak forcepsi dhe ventuza obstetrikale, për shkak të dëmtimeve të rënda shoqëruese si për nënën dhe për bebin, si dhe numri gjithnjë e më i vogël i personelit mjekësor të aftë për ti përdorur. Kështu që të gjitha rastet kur indikohet lindja operative përfundojnë me SC urgjente.

Sa e vështirë është ulja e lindjeve me operacion?

Si përfundim mund të themi se pavarësisht shkakësive së evidentuar më sipër dhe të grupuar në mënyrë skematike, asnjëherë këto situata nuk ekzistojnë të izoluar, por më shpesh në rutinën e përditshme hasim një kombinim të tyre, me rezultat lindjen me SC. Të gjithë faktorët e përmendur si shkaqe të rritjes së numrit të lindjeve me SC janë gjithashtu të integruar dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, duke e vështirësuar më tepër përpjekjen e politikëbërësve të kujdesit shëndetësor për të ulur lindjet me SC.

Voltiza Duro

Shpeshherë na ndodh që barku të rrijë i fortë, i fryrë, të kemi gurgullimë gazrash, të kemi vështirësi në tretje. Në këto raste kemi të bëjmë me dispepsi ose vështirësi në tretje të ushqimit. Shkaqet e këtij çrregullimi funksional mund të jenë të ndryshme si shkaqet stresuese, psikologjike, dietat ushqimore, ndryshimet fiziologjike të mëlçisë, mbingopja etj. Nëse kjo dispepsi zgjat më tepër se 1 deri 2 ditë, duhet vepruar për të ndërhyrë sa më parë për normalizimin e tretjes. Korrigjimi i këtij problemi funksional do të lidhet me faktin sesa ne do të analizojmë: Çfarë kemi ngrënë, çfarë kemi pirë, sa e kemi lehtësuar tretjen me regjimin e te ushqyerit dhe dietën ditore. Për ta kthyer në normalitet tretjen duhet të korrigjohet dieta ushqimore dhe për ta shpejtuar normalitetin duhet të përdorim disa nxitës për tretjen. Tek fëmijët e moshave 0 deri 1 vjeç me shumë sukses mund të përdorni çajin e mendrës së butë dhe kamomilit. Fëmija 0-1 vjeç mund të pijë gjatë ditës disa herë nga 1-2 lugë supe. Ndërsa fëmijët 1-5 vjeç pinë 2-3 filxhanë çaji në ditë. Duke përvëluar në 1 gotë ujë 1 lugë gjelle mendër dhe gjysmë luge kamomil, ne lehtësojmë tretjen dhe luftojmë ngërçin e barkut të fëmijëve. Ky çaj ka veprim karminativ dhe nervoz. Ndërsa te të rriturit krahas dietave, japin rezultate pozitive edhe çajrat aromatikë me veprim karminativ, anti-inflamator nervine. Pra, përgatitja e një çaji bimor me rigon, mendër, borzilok, kamomil, geutian ose valeriane, normalizon shumë shpejt tretjen dhe jashtëqitjen. Çaji më i mirë është ai që përgatitet nga përzjerja bimore si më poshtë: Në 2 gota ujë ziejmë për 1 minutë, 1 lugë gjelle mendër, gjysmë lugë gjelle rigon, gjysmë luge gjelle kamomil si dhe gjysmë luge gjele borzilok. Çaji kullohet pas 10 minutash e nga ky çaj fëmija pi 1-2 filxhanë kafe në ditë, ndërsa të rriturit 2 filxhanë çaji në ditë.

Susami

Vaji i susamit forcon organizmin, ju ndihmon të ndiheni më të fuqishëm, sidomos nëse keni tension të ulët dhe dobësi trupore. Vaji dhe farat e susamit të shtypura duhen konsumuar para ushqimit, në këtë mënyrë ato veshin mukozën e brendshme të stomakut dhe forcojnë sistemin nervor të tij. Këshillohet të përdoret në rast se vuani nga gastriti, djegia e stomakut, apo ulçera. Gjithashtu, ky vaj ndalon të vjellat dhe rregullon pH e stomakut, prandaj largon djegien e stomakut si dhe detoksifikon organizmin dhe eliminon toksinat në gojë dhe komplet aparatin



Mjeku popullor: Trajtimi i tensionit të ulët dhe rënies së imunitetit, me susam

Ylli Merja: Vështirësitë në tretje, kura me bimë medicinale

"Përdorni çajin e mendrës së butë dhe kamomilin"



Mjeku popullor
Ylli Merja

tin tretës, kështu mund të përdoret edhe kundër erës së keqe në gojë. Mund ta përzieni me vaj kokosi për t'i dhënë aromë më të këndshme. Ndërkaq vaji i susamit ushqen lëkurën, e zbut dhe hidraton, në të

njëjtën kohë parandalon rrudhat e ndihmon në rigjenerimin e djegieve. Këshillohet të përdoret pas plazhit i përzier me vaj kokosi në djegiet e lëkurës nga dielli si dhe në rigjenerimin e plotë të saj. Vaji i susamit ushqen edhe

lëkurën e kokës dhe ndalon rënien e flokëve, kështu që rekomandohet të hidhet në shampo sidomos nga personat që vuajnë nga psoriasis ose dermatiti. Edhe personat që vuajnë nga diabeti mund të konsumojnë këtë vaj pasi susami ul sheqerin në gjak.

Problemet me stomakun

Kur në stomak kemi një prishje të pH-it; shkaktohet nga përdorimi i tepruar i alkoolit, duhanit, barnave, rritjes së inflamacionit bakterial nga *Helicobacter pylori*; atëherë në stomak nuk vepron negativisht vetëm një element keqëbërës, por njëherësh disa. Atëherë edhe efektet negative në muret e stomakut do të jenë më të mëdha. Në këto raste skuqja e mureve të stomakut nga brenda si dhe gërryerja e tyre shqërohet shpesh me dhimbje të forta një ose dy orë pas buke. Por shoqërohet edhe me gromësima që nxjerrin një gaz të tharrët në grykë, një avull që shpesh shkakton kollë, ngjirje zëri etj. Në këtë rast kemi të bëjmë me një ulçerë në stomak që formohet kur kemi një dëmtim të mukozës së brendshme të stomakut. Në rastet e ulcerave dhimbjet janë shpesh dhe djegien e madje edhe zgjatën. Shumica e ulcerave shkaktohen nga infeksionet bakteriale dhe bakterit që shkakton ulçerë quhet *Helicobacter pylori*. Ulcerat e tjera mund të shkaktohen nga përdorimi i aspirinës ose i barnave të tjera. Nëse lihen pa u mjekuar ulcerat bëhen problem shqetësues për shëndetin ose degjenerojnë në sëmundje edhe më të rënda. Në këto raste rekomandohet përdorimi i

çajit me gjethet e mëllagës (*Malvia silvestris*), e cila minimizon shumë efektin ulçerë të bakterit *Mucilagjet* që ndodhet në gjethet e mëllagës e kryejnë një rol shumë të mirë mbrojtjeje tek muret e stomakut, në gojë apo në mukozën e përdorimi i 2-3 gotave çaji të përfutur nga zierja 1-2 minuta e 3 gotave të çajit me 3 lugë gjelle mëllagë jep rezultate të mira në efektin mbrojtës të sistemit të tretjes, mushkërive etj. Ndërkohë edhe përdorimi i gjethes së arrës dhe petave të brendshme në këtë frut, bëjnë që të kurohen me shumë sukses ato kruajtjet e brendshme të mureve të stomakut. Ndërsa përdorimi i një të bardhe veze në mëngjes esëll me qumësht bën që të amortizohen plotësisht përplasjet e ushqimit me muret e stomakut, pra frenojnë efektin gërryes të ushqimit brenda mureve të tij. Për të patur të sigurt shërimin e ulcerës është mirë të përdorim një kurë komplekse me vajra bimore dhe esenciale, propolis blete dhe një mikser çajrash. Bimët që këshillohen për problemet e stomakut janë gingeri; turmeric (antiinflamator e fuqishme), gjembogomari (rregullon sasinë e enzimave që prodhohen nga tëmthi e mëlçia). Por këshillojmë të sëmurët të përdorin edhe shलगun (*Ulmus Rubra*), pasi përmban mucilagje, që veshin ezofagun e stomakun. Ndërkohë edhe ananasi përmban enzima tretëse, që largojnë djegien e zemrës dhe fryrjen e zorrëve.



Ushqimet që duhet të konsumoni gjatë menopauzës

Menopauza nënkupton ndërprerjen e ciklit menstrual. Normalisht fillon mes moshës 45-55 vjeç, por mund të fillojë edhe më herët se 45 vjeç apo edhe pas moshës 55 vjeçe. Megjithatë, me fillimin e menopauzës nuk do thotë se fillojnë vitet e pleqërisë. Simptomat e menopauzës mund të fillojnë shumë shpejtë, të zgjasin disa muaj apo edhe vite. Simptomat janë të ndryshme, disa femra e përballojnë më lehtë për të tjera ky është një përjetim shumë traumatik. Femrat lindim me dy vezorë, secila prej tyre përmban miliona vezë. Aktiviteti i vezorëve kontrollohet me hormonet të cilat prodhohen nga truri. Vezorët aktivizohen në pubertet kur edhe fillon cikli menstrual dhe ovulacioni, d.m.th. fillojnë të lirojnë vezë gjatë çdo muaji. Aktiviteti i punës së vezorëve ndalet në menopauzë. Në këtë periudhë vezorët prodhojnë sasi shumë të vogël të hormoneve sidomos të estrogenit, progesteronit dhe testosteronit, të cilët janë shkaktarë të paraqitjes të shumë simptomave në menopauzë.

Ulja e nivelit të hormonit testosteron shkakton uljen e dëshirës për marrëdhënie seksuale, derisa hormoni estrogen ende prodhohet në organizëm edhe pas menopauzës, por në sasi të vogël. Saktësisht nuk e dimë si vjen deri te menopauza. Fëmijët e lindur të nënat pas moshës 35 vjeçe rrezikohen për lindje me Down sindromë. Rreziku i shëndetit të gruas shtatzënë shtohet me moshë. Prandaj, evolucionit e ka krijuar një mekanizëm gjenetik që menopauza të parandalojë lindjen e fëmijëve me të meta. Moshë mesatare e fillimit të menopauzës është 50 vjeçe. Edhe natyra bën gabime, kështu edhe menopauza ndonjëherë fillon para se femra të jetë gati për këtë. Nivelet e hormoneve në rënie, sidomos estrogeni, stresi dhe gjumi i papërshtatshëm, bëjnë që disa femra gjatë menopauzës të jenë të prirura për të fituar peshë, veçanërisht në pjesën e barkut. Për fat të keq, shtimi në peshë gjatë menopauzës nuk është vetëm një gjë e pakëndshme, por dhe e dëmshme për shëndetin. Yndyra që shtresohet nën muret e barkut, ndërlikohet me një rritje të rrezikut për sëmundje të zemrës, presion të lartë

të gjakut dhe rezistencë të insulinës, gjë që mund të çojë në diabet. Ka disa mënyra që mund të bëhen për të mbajtur shëndetin e duhur edhe në këtë fazë mjaft sfiduese për shumicën e grave. Me një mënyrë jetese aktive dhe një dietë të shëndetshme, mund të ndiheni më rehat gjatë kësaj periudhe të jetës suaj.

Aktivitetet fizike

Teksa plakemi, natyrisht që humbim peshën e muskujve. Nëse nuk e zëvendësojmë atë muskul të humbur, trupi ynë do të ketë më pak muskuj, gjë që do të ngadalësojë nivelin metabolik. Qëndrimi

aktiv fizik në vitet '40 dhe '50 të moshës, ndihmon në ruajtjen e metabolismit tuaj.

Lëvizja duhet të jetë pjesë e rutinës tuaj të përditshme. Udhëzimet e aktiviteteve fizike kombëtare rekomandojnë një minimum prej 150 minutash në javë të aktivitetit aerobik si dhe stërvitje të forta, të paktën dy herë në javë.

Të ushqyerit e shëndetshëm Ushqimet e mëposhtme janë veçanërisht të dobishme për gratë në fazën para menopauzës, ose gjatë menopauzës: Bananet së bashku me kajsitë, avokadot dhe patatat e ëmbla, përbëjnë sasi të

larta të kaliumit, gjë që ndihmon në rregullimin e presionit të gjakut. Boronica është plot me antioksidantë, të cilët parandalojnë oksidimin e substancave të njohura si radikale të lira, vitaminë C e cila përpos që vepron si antioksidant në organizëm, zvogëlon rritjen e nivelit të hormoneve (kortikosteronit), që shkakton stresin. Marrja e rregullt e vitaminës C mund të mbrojtë nga ndikimet e dëmshme të stresit, gjithashtu stimulon sistemin e imunitetit derisa fibrat luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin tretës. Zarzavatet errëta me gjethe janë të pa-

sura me kalcium dhe vitaminë K, të cilat ndihmojnë shëndetin e kockave. Gratë mbi 50 vjeç duhet të marrin 1.200 miligramë kalcium çdo ditë. Peshku salmon dhe ushqimet e pasura me Omega-3 rrisin kolesterolin e mirë. Peshqit me vaj, gjithashtu, janë burime të mira të vitaminës D, që ndihmon absorbimin e kalciumit. Nevojat ditore për vitaminë D janë 600 UI. Bukë tërësisht me kokërr dhe bollgur. Studimet tregojnë se fibra e tretshme mund të ndihmojë trupin tuaj të heqë kolesterolin. Kërkesa për fibra zvogëlohet në moshën 50 vjeç, kështu që duhet synuar 21 deri në 30 gramë fibra totale në ditë. Uji nuk siguron energji por shërben për shumë procese tjera, të cilat janë shumë të rëndësishme për organizmin tonë. Mirëmban temperaturën konstante të trupit, shpërbën shumë materie toksike në trup, prandaj njihet për efektin e tij antioksidues etj. Kosi është i pasur me kalcium, që padyshim është një nga mineralet më të rëndësishme për shëndetin e kockave dhe një probiotikë që mund të ndihmojë tretjen, të rrit imunitetin si dhe ndihmon shumë në djegien e yndyrave. Gratë në menopauzë duhet të kenë kujdes në marrjen e natriumit. Kripa është thelbësore për shëndetin, sepse ndihmon në ekuilibrin e drejtë të lëngjeve në trup, ndihmon në transmetimin e impulseve nervore, si dhe ndikon në tkurrjen dhe relaksim të muskujve, por është shumë e rëndësishme të mos tërëto konsumimi i saj.



Këshilla

Efektet e mrekullueshme të kungullit në organizëm

Kungulli është shumë i pasur me beta karoten dhe flavonoidë, të nevojshëm për të luftuar plakjen e qelizave. Gjithashtu, është i pasur me fibra, ndaj rregullon aparatën gastro-intestinal, mbron sistemin imunitar dhe zhvillon një aksion antioksidant. Farat e tij janë të pasura me vitaminë E dhe janë të nevojshme për të eliminuar shqetësimet në aparatën urinar, sidomos në funksionimin sa më mirë të prostatës. Kungujt përbajnë edhe sasi të triptofanit, substancë që ndihmon në prodhimin e serotoninës, e dobishme kundër pagjumësisë dhe depresionit. Për të shijuar përfitimet e farave të kungullit, mjafton t'i piqni në furrë dhe t'ia shtoni sallatës apo gotës së kosit që do konsumoni. Sasia e rekomanduar për konsum është 10 gramë në ditë.

Kungulli, përveç beta karotenit dhe fibrave, ka një përbajtje të lartë të vitaminave A dhe C, kripërave minerale dhe Omega Tre, yndyrat e dobishme, të cilat ndihmojnë në uljen e kolesterolit. Ka edhe veti antioksiduese, përmirëson lëkurën, ndihmon në forcimin e thonjeve dhe flokëve, ndihmon zemrën, lufton infeksionet, ul pagjumësinë dhe stresin. Është e vlefshme edhe në regjimet hipokalorike, pasi sjell vetëm 18 kalori për 100 gramë produkt. Kjo është e mundur, duke qenë se përmban shumë ujë: deri në 94,5%. Karbohidratet nuk kalojnë 3,5%, ndërkohë që proteinat, shumë të pakta, janë vetëm 1,1%. Yndyrat mun-



gojnë. Pra, kungulli ka aftësi të mira diuretike, ndaj ndihmon organizmin në luftën ndaj celulitit. Shija e tij e ëmbël ndihmon të shmangim ëmbëlsirat kur i dëshirojmë, por jemi në dietë dhe nuk mund t'i konsumojmë. Jo të gjithë e dinë se lëkura e kungullit mund të përdoret pasi në të gjenden shumë veti ushqyese, me aftësi antibiotike dhe antifunge. Edhe lulet e kungullit janë të ngrëshme: Mund të konsumohen të si omlëtë me vezë, apo të skuqura thjesht. Tuli i kungullit mund të përdoret edhe si maskë bukurie e bërë vetë.

Mjafton ta shtypësh, apo të përdorësh tulin që ke përfutur nga centrifugimi i blender-it. Përzihet në një enë bashkë me kos dhe mjaltë dhe përftohet një pastë e butë për t'u aplikuar në lëkurë dhe duhet mbajtur për 20 minuta. Kungulli ngadalëson plakjen e lëkurës dhe ka efekt ushqyes, sidomos tek lëkura e thatë, dhe cilësi pastruese në lëkurën e yndyrshme. Falë beta karotenit, tuli i kungullit, si për ta ngrënë, si në kozmetikë, është i vlefshëm edhe për ngjyrën e lëkurës, apo për të shmangur djegien e saj para ekspozimit në diell.



Përdorni hudhrën e kuqe kundër sëmundjeve tumorale

Hudhra e kuqe vlerësohet shumë për vlerat e larta shëndetësore që ka dhe është një varietet i veçantë, që fatmirësisht gjendet në zona të ndryshme të Shqipërisë, por në botë ajo mbetet e rrallë. Ndonëse nuk haset shpesh në tregjet e mëdha, hudhrrat e kuqe gjenden lehtë në tregjet e fshatarëve dhe kanë të njëjtin çmim si ato të bardha. Kjo hudhër quhet e kuqe për shkak të ngjyrës së lëkurës së saj ndonëse thelpinjtë e saj janë të bardhë. Për nga pikëpamja e vlerave ushqimore, hudhra e kuqe ka të njëjtat vlera ashtu si edhe e bardha, por në krahasim me këtë të fundit ka disa veti të tjera më të veçanta shëndetësore. Hudhra e kuqe vlerësohet për përbajtjen e saj natyrale të organosulfurit, një substancë me shumë përfitime për shëndetin e organizmit. Këto



substance vlerësohen se mbrojnë organizmin nga sëmundjet tumorale. Hudhra e kuqe vlerësohet, gjithashtu, për vetitë e forta anti-inflamatore duke luftuar shumë sëmundje kronike, tumore, obezitetin, sëmundjet e zembrës ashtu si edhe diabetin. Gjithashtu, ajo ka fuqi kundër infeksioneve, virozave dhe baktereve duke vepruar si një antibiotik i vërtet natyral në organizëm. Hudhra e kuqe është një burim i mirë vitaminash dhe mineraleve ndërsa vlerësohet për vetitë e saj antioksidante. Hudhra e kuqe veçon për shijen e saj të fortë, të thellë dhe pak pikante. Ajo përdoret në receta të shefave prestigjioze të kuzhinës në përgatitjen e salcave të ndryshme.

"Veçernji list" interviston gjeneralin e FSK: Gjithçka sipas standardeve të NATO

Gazeta kroate reportazh për Kosovën: Njihuni me ushtrinë e re

Hadërgjonaj për gazetarët: Jeni të privilegjuar

Gazeta më e madhe kroate, "Veçernji list", ka bërë një reportazh në lidhje me ushtrinë e Kosovës. E shihni, gjithçka çfarë bëjmë është sipas standardeve të NATO-s. Me këtë fjali të gjeneral-brigade të FSK-së, Fadil Hadërgjonaj e nis reportazhin për ushtrinë e Kosovës, gazeta më e madhe kroate "Veçernji list". Me titullin "Video ekskluzive Veçernji i pari në përgatitjen e forcave të armatosura të Kosovës", gazeta kroate e vazhdon reportazhin e gjatë me deklaratën tjetër të Hadërgjonajt se "ndjehet i nderuar që keni ardhur nga Kroacia në Istog, në poligonin e ushtarëve të rinj të NATO-s, ku pikërisht fillon përgatitja e ushtrisë së ardhshme të Kosovës". Gazeta tutje shkruan për vendimin e parlamentit të Kosovës që FSK-në ta shndërojë në ushtri me 5000 ushtarë. "Forcat e Sigurisë së Kosovës deri më tani kanë pasur mision të kufizuar. Deri më tani ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit të Kosovës e kanë pasur forcat e KFOR-it, të cilat i kanë 4000 ushtarë në këtë territor. Forcat e NATO-s këtu janë të vendosura për gati dy dekada, menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë", shkruan tutje "Veçernji list", përcjell metro. Më pas në reportazh thuhet se tanimë pas transformimit të forcave të sigurisë në ushtri, ruajtja e integritetit dhe sovranitetit të Kosovës do të jetë detyrë e Forcave të Armatosura të Kosovës. Për të parë më afër zhvillimin e ushtrisë së Kosovës, brigada për ndërhyrje dhe shpejtë "Ujgit" ka demonstruar para gazetarëve kroate kapacitetet që përmban dhe sa është e gatshme të përballlet me sfidat që i dalin përpara nëse cenohet integriteti dhe sovraniteti i Republikës së Kosovës. Gazetarët



FADIL HADËRGJONAJ

"Me besoni, jeni të privilegjuar, pasi që po mos të ishit nga Kroacia, do të ishte në pikëpyetje se a do të hynit apo jo në bazë", ka thënë duke qeshur, gjenerali i FSK, Fadil Hadërgjonaj.

kroate në Istog janë pritur nga gjeneral-brigade, Fadil Hadërgjonaj. "Me besoni, jeni të privilegjuar, pasi që po mos të ishit nga Kroacia, do të ishte në pikëpyetje se a do të hynit apo jo në bazë", ka thënë duke qeshur, Hadërgjonaj. Gazetarët kanë folur edhe me ushtarin e brigadës, Argjend Lokaj, i

cili iu ka thënë se shumë të rinj dëshirojnë t'i bashkohen ushtrisë, por sipas tij, fatkeqësisht nuk ka edhe aq shumë kapacitete aktualisht. "Për neve ushtria është gjithçka, nder, krenari dhe identiteti. Prindërit e mi kanë qenë pjesëtarë të UÇK-së, ushtria që e glori Kosovën, ndërsa tash detyra

jonë është që ta ruajmë lirinë dhe pavarësinë", ka thënë ndër të tjera Argjendi. Ky reportazh i kroatëve vjen në kohën kur në Serbi ka kundërshtime dhe spekulime të mëdha për Ushtrinë e Kosovës. Me këtë, gazeta kroate tregon edhe një herë se aleatin më të madh në Ballkan Kosova e ka Kroacinë, kuptohet pas Shqipërisë. Ndërkaq FSK u shpall si ushtri zyrtarisht në fillim të muajit nga ku edhe nisën diskutimet për buxhetin që do t'i kalojë për t'u transformuar. Transformimi dhe ngritja e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kos-

MEDIA KROATE

"Forcat e Sigurisë së Kosovës deri më tani kanë pasur mision të kufizuar. Deri më tani ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit të Kosovës e kanë pasur forcat e KFOR-it, të cilat i kanë 4000 ushtarë në këtë territor. Forcat e NATO-s këtu janë të vendosura për gati dy dekada, menjëherë pas përfundimit të luftës në Kosovë", shkruan tutje "Veçernji list".



Ministria ruse: Kosova duhet të mbetet nën mbikëqyrjen e ndërkombëtarëve

Ministria e Punëve të Jashtme e Rusisë ka lëshuar një paralajmërim të ashpër ndaj përpjekjes së Kosovës që të krijojë ushtrinë. Ministria e Jashtme ruse ka shprehur shqetësim për vendimin e Kuvendit të Kosovës për t'i shndërruar Forcat e Sigurisë së Kosovës në ushtri të plotë. Kjo ministri ka theksuar se një vendim i tillë dëmton stabilitetin e Ballkanit. "Rusia i ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen komunitetin ndërkombëtar se tendencat e tilla nuk janë në përputhje me Rezolutën 1244, e cila thotë se Kosova duhet të mbetet nën mbikëqyrjen e ndërkombëtarëve", thuhet në deklaratën e ministrit ruse. "Askush nuk mund të japë garanci se të ashtuquajturat forca të armatosura, të cilat përbehen nga terroristë të UÇK-së, nuk do të përdoren në dëm të kundër popullatës serbe në veri", thekson MPJ ruse. Tutje thuhet se ata që mbështesin Kosovën po përpunojnë shpejtësi të riorganizojnë FSK-në në ushtri të plotë në mënyrë që të transferojnë ish-militantët nën patronazhin e NATO-s. "Ushtria e Kosovës dëmton stabilitetin në Ballkan dhe nuk është në përputhje me të drejtat e atyre që jetojnë atje dhe e meritojnë një të ardhme të qetë dhe të sigurt", përfundon deklarata e MPJ-së. Kundër Ushtrisë së Kosovës është shprehur edhe qeveria e Serbisë, zyrtarë të së cilës kanë deklaruar se do të përdorin çdo mekanizëm për ta parandaluar themelimin e saj.

Kosovë, shifrat alarmante të të rinjve që konsumojnë marijuanë

Ndalimi i shpërndarjes nga nëntëvjeçarët tek të mesmet, sfidë e institucioneve të Sigurisë

Një ndër problemet shqetësuese në Kosovë është dhe rritja e numrit të konsumatorëve të lëndëve narkotike. Narkotikët dhe përdoruesit e drogës po vazhdojnë të paraqesin sfidë për institucionet e Sigurisë në Kosovë. Detyrë edhe më e rëndë po konsiderohet ndalimi i shpërndarjes drogave nëpër shkollat fillore dhe të mesme. Nga të dhënat e poseduara, numri i konsumuesve të drogave dallon varësisht prej llojit. Kështu ka konstatuar Policia e Kosovës në një përgjigje për lajmi.net, tek sa shtojnë se numri i konsumuesve të heroinës ka rënë dukshëm, ndërsa është rritur numri i personave që konsumojnë marijuanë.

Sipas rasteve të regjistruara në polici, moshë tek të cilat më së shumti frekuenton droga, është 21 deri në 35 vite. Kësajsoj, lidhur me veprën penale të posedimit, shpërndarjes apo shitjes e paautorizuar të narkotikëve, nga periudha janar-gusht të këtij viti janë arrestuar gjithsej 1 mijë e 392 persona. Nga 1 mijë e 487 persona të dyshuar lidhur me këtë veprë penale, 57 prej tyre janë femra. Gjatë të njëjtes periudhë janë konfiskuar mbi 536 kilogramë marihuanë, që paraqet ulje të sasisë për rreth 43 kilogramë të konfiskuar gjatë të njëjtes periudhë të vitit të kaluar. Poli-

cia e Kosovës është angazhuar si në fushën e parandalimit ashtu edhe në fushën operative-hetimore (luftimit) të kësaj dukurie. Në fushën e parandalimit ka hartuar Urdhrin Operativ "Stop drogës në shkollë" me ç'rast janë realizuar aktivitete në vazhdimësi për parandalimin dhe luftimin e dukurisë së drogës në shkollë dhe rreth tyre, janë realizuar kontakte me prindër, takime me ekipet për siguri, forume rinore, plane operative në pikat kufitare dhe në Vijën e Gjelbër dhe aktivitete të tjera në bashkëpunim me organizatat relevante qeveritare dhe OJQ,

Këto aktivitete kanë treguar rezultate pozitive në parandalim dhe sekuestrim. Kultivimi nuk është shumë i theksuar në Kosovë. Mbjellja bëhet kryesisht nga përdoruesit për përdorim personal në sasi të vogla, me ndonjë rast ku është tentuar të kultivohet në sasi më të madhe, por ekzistojnë edhe vende ku kanabisi mbin vetvetiu (bimë të egra), vende të cilat policia i ka identifikuar dhe bimët janë shkatërruar në fazën e hershme. Për parandalimin e kultivimit policia me parë ka realizuar patrullime me helikopter në bashkëpunim me KFOR-in dhe EULEX-in,

kontrollin e lokacioneve të dyshuara me dronë, dhe shkëmbim të informatave në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët. Nga droga, e cila hyn nga vendet tjera, në bazë të statistikave rreth 10% është e destinuar për konsumim vendor ndërsa rreth 90% për tregun e jashtëm. Theksojmë se në mbledhjen e fundit të qeverisë së Kosovës, kryeministri Haradinaj ka kërkuar masa konkrete nga ministri i Brendshëm, Ekrem Mustafa, hartimin e planeve operative për ndalimin e shpërndarjes së drogave nëpër shkollë. Në kuadër të këtij plani, parashihen takime të zyrtarëve të ministrisë me komandantët e policisë. Lidhur me rezultatet e këtij operacionit, ministri i Brendshëm do të raportojë në qeverinë e Kosovës.

Vrasja e Konstandinos Kaçifës, reagon ashpër partia "Agimi i Artë"

"Vritini qentë shqiptarë", protestë para ambasadës shqiptare në Athinë

Mbrëmjen e së dielës disa dhjetëra protestues, kryesisht mbështetës të "Agimit të Artë", u mbledhën përpara ambasadës shqiptare në Athinë për të protestuar kundër vrasjes së 35-vjeçarit Kostandinos Kaçifa. Protestuesit, sipas mediave helene u mbledhën pas thirrjeve në internet të publikuara nga sindikatat në Athinën Veriore dhe nga partia e ekstremit të djathtë "Agimi i Artë". Me flamuj në duar, ata protestuan për



vdekjen e Konstandinos Kaçifës duke mbajtur fotot e tij në duar dhe duke ndezur qirinj, por edhe lëshuan thirrje antishqiptare si: "Shqiptarët vrasës, po vrisni vëllezërit tonë në tokën greke" apo "Çekiç dhe zjarr për qentë shqiptarë". Në protestë është parë dhe kreu i "Agimit të Artë", Ilias Kasidiaris, ndërsa një ndër sheshet kryesore të Athinës, Kifissia, u mbyll

nga policia për shkak të kësaj proteste. Ndërkaq kujtojmë se Kastandinos Kaçifa u ekzekutua nga forcat RENEJA në një fshat të Gjirokastrës. 35-vjeçari nga Greqia hapi zjarr ndaj bluve, por fatmirësisht askush nuk u prek nga plumbat. Ndërkaq paraditen e së dielës autori ishte fshehur pranë depos së ujit në Bularat, ndërkohë që mes tij dhe policisë ka pasur shkëmbim zjarri. Po ashtu 35-vjeçari qëlloi herë pas here ndaj policisë pasi kur u largua nga vendi i ngjarjes kishte edhe tre karikaturë me vete.

Merkel, fituesja dhe humbësja e madhe në Hessen

Në Hessen u mbajtën sot zgjedhjet për parlamentin e landit, ku u dërguan sinjale të fuqishme në drejtim të Berlinit. Humbëset më të mëdha të zgjedhjeve janë dy partitë deri tani më të mëdha në vend - CDU dhe SPD. Partia kristiandemokrate (CDU) e Kancelares Angela Merkel ka fituar numrin më të madh të votave në landin Hessen. Por njëkohësisht kristiandemokratët janë edhe humbësit më të mëdhenj të këtyre zgjedhjeve, pasi CDU shënoi rezultatin më të dobët në këtë land, që nga viti 1966. Pas mbylljes së vendotimeve u tha se partia CDU ka fituar vetëm 27,4% të votave (rreth 11% më pak se në zgjedhjet e kaluara). Humbëset më të mëdhenj të këtyre zgjedhjeve janë socialdemokratët (SPD), të cilët kanë shënuar rezultatin më të dobët zgjedhor në këtë land, pas Luftës së Dytë Botërore. SPD sipas të gjitha gjasave ka zënë vendin e dytë në zgjedhje, por kjo parti fitoi vetëm 19,6% të votave. Edhe kjo parti ka shënuar një rënie prej rreth 11%. Në këtë mënyrë, zgjedhësit në Hessen dërguan sinjal shumë të qartë në drejtim të qeverisë federale, sepse shumë zgjedhës në Gjermani nuk janë të kënaqur me qeverisjen federale dhe me grindjet në koalicionin e partive deri tani më të mëdha në Gjermani. Fituesi më i madh i zgjedhjeve në Hessen janë ekologjistët, të cilët tani janë forca e dytë në parlamentin e landit. Ata fituan 19,5% të votave (8,4% më shumë se para katër vitesh), që do të thotë se ekologjistët do të jenë partia e tretë më e madhe në këtë land.

Populistët edhe në Hessen Ndër fituesit e këtyre zgjedhjeve është edhe partia populiste, Alternativa për Gjermani (AfD), e cila ka fituar 13% të votave. Në këtë mënyrë, kjo parti me qëndrime armiqësore ndaj të huajve është futur tani në të gjitha 16 landet e Gjermanisë. Në parlamentin e landit Hessen janë futur edhe liberalët (FDP) dhe e Majta. Liberalët fituan 7,8% ndërsa e Majta 6,0% të votave.

Koalicionet mbeten të hapura Në Hessen deri tani në pushtet kanë qenë partia CDU dhe ekologjistët. Mbetet të shihet nëse kryeministri i deritanishëm Volker Bouffier do të arrijë të vazhdojë këtë koalicion, apo do të ketë ndonjë koalicion tjetër. Në reagimet e para CDU dhe SPD i shprehën të pakënaqura. Relativisht të kënaqur ishin ekologjistët, të cilët kanë fituar shumë, duke shënuar rezultatin më të mirë historik në këtë land. Por ata kanë pritur edhe më shumë. Ndërsa më të kënaqurit ishin populistët e AfD.

Gazeta greke raporton kërcënimin: Një luftë me Turqinë përfundon në katastrofë

Këshilltari i Erdogan: Greqinë mund ta shkatërrojmë për 3-4 orë

Yigit Bulut: Prezenca jonë në Egje sa 3-fishi i grekëve

Vijon ende "lufta" e ftohtë midis Grekisë dhe Turqisë. Kësaj radhe është Athina ajo e cila po kërcënohet përsëri nga Turqia. Këshilltari i Presidentit Erdogan, Yigit Bulut tha se në rast të një luftime mundshme mes Turqisë dhe Grekisë, kjo e fundit shkatërrohet brenda 3-4 orësh. Gazeta greke "Prothema" ka publikuar ato që i quan kërcënime të reja të Bulut gjatë një emisioni televiziv në kanalin shtetëror turk. Gjatë programit "Analiza e Thellë", Bulut i kujtoi Athinës se "prezenca ushtarake e Turqisë në Detin Egje është sa 3-fishi i Grekisë. Një luftë e Grekisë me Turqinë përfundon në katastrofë për Greqinë. Zgjat vetëm 3-4 orë dhe përfundon me katastrofë për Greqinë". Sipas tij ishte Izraeli që i siguronte Grekisë informacione të siguruar nga avionët UAV në mënyrë që t'i përdornin kundër anijes turke "Barbaros". Ndërkaq kujtojmë se një situatë e tillë e ndërë vijon prej një kohe shumë të gjatë. Ndërkaq një muaj më parë një situatë e tensionuar është shënuar në zonën kufitare mes Turqisë dhe Grekisë në Evros, pasi është ndaluar një ushtarak turk. Sipas mediave lokale, ushtaraku është ndaluar në brendësi të territorit grek, por ende nuk dihen rrethanat, ndërsa burime mediatike bëjnë me dije se ka pasur të shtëna me armë në ajër. Situata mund të jetë delikate në këtë rast, pasi kujtojmë se disa muaj më parë dy ushtarake grekë u ndaluan prej një patrulle turke dhe u mbajtën për 4 muaj në një burg ushtarak turk. Turqia paralajmëroi Greqinë se nuk do të tolerojë një ndryshim në kufirin detar grek. Paralajmërimi vjen pak ditë pasi Athina



Këshilltari i Erdogan, Yigit Bulut

tha se kishte planifikuar të zgjeronte ujërat e saj territoriale deri në 12 milje në perëndim të vendit. Ujërat territoriale janë një çështje e ndjeshme ndërmjet dy vendeve fqinje që ndahen nga Deti Egje. Greqia tërhiqet nga zgjerimi i vijës kufitare. Burime të sigurta diplomatike kanë bërë me dije për Top Channel mbrëmjen e së martës se Athina ka ndryshuar qëndrim lidhur me shpalljen e zgjerimit të vijës së saj bregdetare nga 6 në 12 milje. Ka qenë një vendim i marrë pas një mbledhje me dyer të mbyllura që ministri i Jashtëm dhe njëkohësisht edhe kryeministër i vendit, Aleksis

Tsipras, me stafin më të lartë politik të kësaj ministrie, si dhe diplomatë të lartë në vendin fqinj. Burimet sqaruan se ky vendim i Athinës zyrtare u mor pasi, sipas kryeministrit, përpara se të kërkojë prej presidentit të firmosë dekretin për një çështje kaq madhore siç është zgjerimi i sovranitetit në Jon edhe Egje, duhet më parë që të informohen edhe liderët e partive parlamentare, si dhe të ketë konsultime me presidentin. Jo zyrtarisht, thuhet se ky vendim i anuncoar prej ministrit në ikje Nikos Kotzias tri ditë më parë, gjatë ceremonisë së dorëzimit të portofolit ministror,

tek pasuesi i tij, Aleksis Tsipras, ka shqetësuar SHBA, por edhe Turqinë. Mësohet se pala amerikane ka kërkuar anulimin e këtij vendimi, ndërsa më herët ministri i Jashtëm turk Mevlit Çavushoglu, deklaroi se çdo veprim i Athinës për zgjerim të vijës së saj bregdetare, në Jon ose Egje, do të përbëjë për të, "Casus Belli" (shkak për luftë). Lidhur me këtë çështje, nuk ka pasur asnjë reagim nga pala shqiptare, e cila tre ditë më parë kishte pohuar se zgjerimi i vijës bregdetare me Grekisë dhe Shqipërisë, është e drejtë e të dy vendeve, dhe se ajo mund të shtrihet në zonat ku kjo do të ishte e mun-

YIGIT BULUT
"Prezenca ushtarake e Turqisë në Detin Egje është sa 3-fishi i ynë. Një luftë e Grekisë me Turqinë përfundon në katastrofë për Greqinë. Zgjat vetëm 3-4 orë dhe përfundon me katastrofë për ne" është thënë në emisionin grek.

dur. Turqia dhe Greqia kanë pasur mosmarrëveshje për shelfin kontinental përkatës prej shumë dekadash. Turqia ka paralajmëruar më parë se nuk do të përjashtonte një veprim ushtarak për të mbrojtur interesat e saj. Ish-ministri i Jashtëm grek Nikos Kotzias, i cili dha dorëheqjen javën e kaluar, tha të shtunën se Athina ka planifikuar të zgjerojë ujërat territoriale në detin Jon, por kjo nuk do të prekte rajonin e Egeut. Ministria e Jashtëm e Turqisë, megjithatë, tha se kishte marrë shënime deklarata e Athinës rreth planeve për një zgjerim gradual të ujërave territoriale greke.

Opinion i Ditës

Pse po i stërvit shteti!!!

Nga Fisnik Zicishti

(vijon nga faqja 1)

...Armatura Shqiptare kanë drejtimin e disa operacioneve paqeruajtëse në krah të partnerëve që luftojnë terrorizmin në vendet, të cilat janë në krizë dhe ne si shtet krenohemi me ta. Usharakët tanë shembullorë janë të barabartë në kryerjen e detyrave taktike operacionale me vendet e tjera të Aleancës dhe ia kanë dalë shumë mirë në kryerjen e detyrave, ashtu siç në shkollën e shqiptarëve për shtat si bijtë e Skënderbeut dhe të Ismail Qemalit. Po ashtu edhe pjesëtarët e Rojës Bregdetare Shqiptare luftojnë çdo ditë kontrabandën në ujërat tona territoriale dhe shpëtojnë jetë njerëzish në operacionet SAR. Po vallë çfarë i mundon ata që kthehen në bankë e të akuzuarve? Kanë qenë të shumta rastet në këto vite që usharakët tanë nën uniformë apo të liruar prej saj kanë qenë të përfshirë në vrasje dhe në vjedhje dhe kjo ka disa arsye dhe unë po i rendis si me poshtë: gjendja ekonomike zë vendin kryesor. Po t'i krahasojmë me vendet partnere të NATO-s një ushtarak shqiptar merr minimalisht tri herë me pak pagë mujore se një kolegj i tij, i cili është pjesëtar i forcave të NATO-s. Usharakët tanë për të nxjerrë shpenzimet mujore dhe t'i plotësojnë kushtet familjeve të tyre janë të detyruar të bëjnë dy punësime si bodyguard në klubet e natës apo diku gjetkë. Janë të shumtë ata që kanë dalë në lirim



si pasojë e ligjit të gradave për mos avancim në karrierë dhe si të papunë, në shumicën e rasteve janë gjendur në mes të rrugës duke u marrë me gjëra të jashtë

ligjshme dhe janë vënë para drejtësisë, disa prej tyre edhe kanë dezertuar në vendet e tjera të NATO-s. Shteti shqiptar po humbet shumë, po humbet ata fil-

iza, të cilët i ka stërvitur nder vite dhe po i kthen ata në vrasës e kriminelë kjo nuk është aspak gjë e mirë pasi ne po humbim e humbim çdo ditë ne po humbim

pjesën me të pastër të shoqërisë po humbim ushtarakët shqiptarë po humbim ata që deri dje jemi krenuar prandaj dikush duhet të reflektojë dhe të thotë: STOP!

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Opinion i Ditës

Sinoptika politike: Parashikohet një dimër opozitar me shira dhe breshër të përkohshëm

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faja 1)

...diçka, sidomos nga opozita. Opozita e bashkuar edhe pse ka pasur një aktivitet të admirueshëm në denoncimet e aferave korruptive dhe të krimit, sërish nuk është ajo opozitë që presin qytetarët. Edhe në rastet kur liderët e opozitës janë pyetur për atë se çfarë pritet prej tyre në ditët në vazhdim, ata kanë venë popullin të parin. Ata presin nga populli që të ngrihet, si dikur, në dhjetorin e nëntëdhjetës. Mirëpo, populli nuk është më ai i pari, pjesa më e mirë e atyre qytetarëve që e kuptonin drejt revoltën popullore kanë ikur në emigracion. Pjesa tjetër është shumë e mefshtë pa eksperiencë dhe pa udhëheqje. Rinia studenteske opozitare thuajse nuk ekziston fare. Nga ana tjetër, dhe opozita, me gjithë këto faktorë nxitës, për një protestë të madhe, mbarëpopullore, nuk është e sigurt në fitoren e saj. Kështu që, Edi Rama, ka të drejtë të thotë që me Lulzim Bashën jetëqeverisjen do ta kem shumë të gjatë. Populli opozitar pret me një farë mosbesimi ndaj opozitës, pasi ende nuk ka gjetur liderin e saj që t'i shkojë pas me besim të plotë. Kështu, në prag të këtij dimri mendoj se ekziston një dimër i madh i opozitës dhe jo vetëm i opozitës, por edhe i mazhorancës, imazhi i të cilës ka kohë që është nëpërkëmbur.

Ky dimër i madh i politikës, nuk ka asnjë lidhje me "Dimrin e madh" të politikës së viteve 1961, përshkuruar te romani i I.Kadaresë, pasi, kemi të bëjmë me dimër politik, rezultat i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Së pari, ende nuk ka mbërritur dirigjenti i politikës shqiptare. Është fjala për ambasadorin e ri amerikan, të cilit i ka lënë amanet ambasadori që shkoi, që të kapë peshqit e mëdhenj të Shqipërisë. Këto ditë është pëshpëritur për një peshk të madh, për një kryetare të një bashkie të madhe, por, pikërisht në ditët që pritet që prokuroria dhe policia të bënte punën e vet, jep dorëheqjen ministri i Brendshëm.

Qysh kur nisi mandatin e ri kjo mazhorancë e re, u dëgjua slogani: "Skeni parë gjë akoma". Për çfarë pamjesh e kishte fjalën Rama? Çfarë nuk kishte parë gjë akoma shqiptarët? As atëherë dhe as tani askush nuk e ka kupeuar. Mos e kishte fjalën për rritjen e taksave dhe për përhapjen e kanabisit në mbarë Shqipërinë? Nuk besoj. "Nuk kemi parë gjë akoma", tha dhe Saimir Tahiri kur doli nga dyert e prokurorisë. Për çfarë pamjesh e kishte fjalën ish-ministri i Ministrisë së Brendshme. Të gjithë mediat e transkriptuan thënien e tij si



një kërcënim i hapur për kryeministrin Edi Rama, në qoftë se ai do të rrinte sehirxhi dhe nuk do ta mbronte në aferat e tij hashash-jane dhe në raportet e tij intime korruptive me vëllezërit Habilaj "Ne s'kemi parë gjë akoma, -iu kundërvu Monika Kryemadhi nga podiumi i parlamentit, nga pozicioni i opozitares, -por dhe ti nuk ke parë gjë akoma" Ku e kishte fjalën Monika? Askush nuk e kuptoi. Mos e kishte fjalën për çizmen e njëzet e një dhjetorit, flakur drejt Edi Ramës? Shqiptarët priten të marrin vesh se çfarë nuk është parë akoma? Vrasin mendjen dhe presin vitin e ri me surpriza të reja. Ata e dinë mirë që nuk kanë parë gjë akoma ndaj dhe presin. Presin nga gjyqtori...Presin nga vetingu. Presin nga mazhoranca. Presin nga opozita...Po të mendosh, pritishtërinë e një vetingu, ku, sipas ambasadorit Lu pritet të kapeshin në rrjetë katër peshq të mëdhenj të politikës shqiptare dhe të denoncohenin së paku njëzet të tjerë, peshq të vegjël, atëherë, sigurisht, ky dimër që vjen parashikon një dimër me ngjira të ftohta politike. Po të shkohet me sinoptikën e ambasadorit Lu, i cili iku duke ëndërruar se do të priteshin qudira nga gjyqësori dhe prokuroria, nën një udhëheqje të re, cilido prej nesh arrin në konkluzionin se tashmë, pas një viti, sinoptika politike parashikon një dimër opozitar me stuhi dhe breshër të përkohshëm,

si dhe rënie të ndjeshme të temperaturave gjatë muajve-dhjetor-janar-shkurt. Parashikohet një dimër opozitar me reshje dhe stuhi debore, dhe në muajt shkurt dhe mars. Ajo që nuk dihet gjer më tani, ose që dihet mirë nga të gjithë, është ajo, që nga ky dimër nuk do ta pësojë asnjë peshkaqen i madh, do ta pësojnë ca cironka dhe populli i cili pret, se nuk ka parë gjë akoma. Të gjitha palët kundërshtarë duhet të jenë të përgatitura për të duruar këtë dimër të madh, me taksat e reja që priten të rriten gjatë muajit janar, por më së shumti duhet të jetë i përgatitur biznesi dhe vetë populli.

Ka shumë mundësi që ky dimër të quhet "Dimri vetmisi së madhe" për shqiptarët, duke menduar se dhe konstilacioni i lëvizjeve të fuqive të mëdha parashikon lëvizje jo stabilizuese. Për sa kohë që ky dimër i brendshëm, por dhe i jashtëm, i raporteve jo të qëndrueshme me shtetet e tjera, do të jetë i tillë, ky dimër parashikohet të jetë një dimër i vetmisi së madhe.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e Bashkimit Europian. Nuk mendohet të ndërhyjnë në punët tona, lesh e li, kështu që, edhe pse do të ketë ca vajtje-ardhje emisarësh europianë izolimi do të jetë i plotë.

Për vetë natyrën diplomatike shtetet aleate nuk do të duan të ndërhyjnë në punët tona të brendshme dhe as do të mbajnë anën e njëres palë. Mendohet të

jetë një politikë asnjëans, e galvaniuar me fjale këshilluese. Fjalë këshilluese, jepte dhe ambasadori Lu, në mbështetje të Kukullës kryeprokurore, me idenë se ata do ta kenë në dorë ta manipulojnë në nxjerrjen e gështenjave nga zjari me duart e një zonje të brishtë.

Ata do të qëndrojnë në prapavijë, si stimulues dhe si këshillues të reformave, që do të thotë, le të presim sa të dobësohet njëra palë ose të dy palët njëherësh, që të ndërhyjmë me platformat tona.

Greqia ka hedhur ca para për interesat e veta, por, ato para, të cilat, sigurisht, i kanë përlarë ca shqiptarë, analiste dhe deputetë, nga ai lloji që e shesin Shqipërinë për tridhjetë aspra, ato para kanë shkuar për vila dhe pallate. Serbisë gjithmonë e më tepër po i mpaket dhe plaket ëndrra e saj për Serbinë e madhe.

Cilët do të jenë ata individë apo ato forca politike që pritet të udhëheqin vendin? Kush do të evidentojë provat dhe faktet për të kaluar te arrestimet e të ashtuquajturve "Peshq të mëdhenj"? Gjer më tani, pas katër vjet hetimesh nga një prokurori e huaj, ka dalë vetëm një 'peshkaqen' i mundshëm, i madh, që quhet Saimir Tahiri.

Dhe ky "peshk" supozohet si i mundshëm, pasi parlamenti pranoi një hetim në gjendje të lirë...ndërsa kryeprokuroerja, ia ktheu me xhentilencë pasaportën e bllokuar, me urimin: "Kalofsh një vit të ri dhe vite të tjera të rinj, pa andralla!"

Vetë vënia në krye të prokurorisë, me aq nxitim, të një prokuroreje, e sponsorizuar nga Hulusi Manja dhe Ermonela Felaj, është një sinjal i keq. Problemet dhe individët janë kokolepsur keq. Si gjithmonë, pritet shokolepsja nga të huajt, gjë që nuk pritet të ndodhë. Konkluzioni: "U mbars mali polli një mi."

Po le të kthehemi të fillimi. Sipas liderit Basha kjo lëvizje e re për përmbysjen e pushtetit do t'i besohet masës popullore. E dimë që kemi një opozitë, e cila kujton se me anë të demonstratave të mëdha popullore do t'i bëjë presion qeverisë për t'i lënë karriget. Prej këtyre demonstratave askush nuk shpreson se mund të zgjidhet diçka... "Duhet bërë një revolucion!" thotë Sali Berisha. Pritet gjithnjë nga populli dhe ashtu si gjithnjë faji i faturohet popullit...Populli është një masë amorfë, e pa organizuar, pa sindikata dhe pa shoqëri civile. Populli nuk nxjerr dot një lider të vet. Populli shkon ende pas partive. Populli pret të ndodhë diçka. Nga lëvizjet dhe vendimet e janarit them që opozita nuk ka parë gjë akoma, por dhe mazhoranca nuk ka parë gjë akoma.

HOROSKOPI

DASHI

Sot do të keni kohë mjaftueshëm për t'ia kushtuar vetes, mbi të gjitha shëndetit tuaj. Është koha e duhur t'i tregoni ambicet prindërve. Ata do t'ju mbështesin plotësisht për planet tuaja. Sa i përket jetës romantike, do të kaloni një ditë të mrekullueshme.

DEMI

Do të ndiheni shumë mirë nga ana shëndetësore. Sot do të keni mundësi të rrisni të ardhurat tuaja, pasi do të mbidhni borxhet e mbetura pas. Do të jetë një ditë e mirë për të rigjallëruar lidhjet me disa miq të vjetër.

BINJAKET

Mbështetja nga personat me shumë influencë do t'ju rrisë reputacionin. Do të arrini të shlyeni të gjitha borxhet e familjes. Sot do të zbuloni se jeni shumë i/e dashuruar dhe gjithçka do t'ju duket më e bukur. Sa i përket çifteve të martuar, jeta juaj duket e mrekullueshme.

GAFORJA

Luani me fëmijët që të largoni stresin. Të ardhurat tuaja do të rriten në mënyrë. Një miq juaj mund t'ju kërkojë këshillë për të zgjidhur një problem personal. Mund të bezdisni partnerin/partneren tuaj duke zgjatur telefonatën. Dikush mund të përpigjet të ndërhyjë në jetën tuaj bashkëshortore.

LUANI

Familja pret shumë prej jush, çfarë edhe mund t'ju irritojë. Ka gjasa të arrini një marrëveshje financiare, e cila do t'ju sjellë para. Bëni kujdes, pasi dikush mund të përpigjet të shkatërrojë imazhin tuaj.

VIRGJERESHA

Bëni kujdes gjatë ditës, pasi rrezikoni të bëheni pjesë e një incidenti. Është koha e duhur për t'u përfshirë në aktivitete fizike. Aftësia juaj për të vepruar shpejt do të vlerësohet maksimalisht. Sot është dita kur ju mund të përfjetoni vetëm në pozitë të martesses.

PESHORJA

Vëllai/motra do të tregohen më mbështetës siç e prisnit ndaj nevojave tuaja. Marrëdhënia në çift do të lulëzojë. Sot bashkëshorti/bashkëshortja juaj do t'ju bëjë të ndiheni sikur të ishit personi i vetëm në këtë botë. Dikush nga e kaluara mund t'ju kontaktojë dhe mund të kaloni një ditë të paharrueshme.

AKREPI

Gjatë ditës së sotme do t'ju krijohet mundësia për t'u relaksuar. Natyra juaj sharmante dhe personaliteti i këndshëm do t'ju ndihmojë të krijoni miq të rinj. Sensi i humorit do të jetë aseti juaj më i madh.

SHIGJETARI

Bashkëshorti/bashkëshortja juaj mund t'ju bëjë një surprizë të paharrueshme. Nëse e organizoni ditën më mirë, do t'ju krijohet mundësia për më shumë kohë të lirë, të cilën mund t'ia kushtoni vites tuaj. Të ardhurat financiare parashikohen të jenë të kënaqshme.

BRICJAPI

Duhet të ecni më shumë në kuadër të shëndetit tuaj. Sot ka gjasa të dilni për shopping dhe të argëtoheni me miqtë ose familjarët tuaj. Bëni kujdes me shpenzimet, mos tejkaloni buxhetin tuaj.

UJORI

Mos u shqetësoni për shëndetin sot, pasi do të ndiheni mjaft mirë. Njerëzit rreth jush do përipien t'ju ngrënë moralin. Duhet të punoni më shumë për t'ardhur në ndihmë edhe familjes. Bëni kujdes me sendet tuaja personale, pasi ka gjasa t'ju humbasë diçka e rëndësishme.

PESHQIT

Ndenja e urrëjtjes mund t'ju kushtojë shtrënjtë. Jo vetëm do të ndikojë negativisht tek toleranca juaj, por mund të krijojë përgarje të përershme. Ka gjasa që problemet tuaja financiare të marrin fund. Do të nisni të shihni anën tjetër të dashurisë, çfarë do t'ju bëjë marrëdhënien të mrekullueshme.

Luftëtari fiton sfidën e mbijetesës me Kastriotin

Kukësi thyen Laçin dhe kërcënon dyshen kryesuese Partizani-Skënderbeu

Braziliiani Uilliam Kor deiro nderon Kukësin në transfertën e vështirë ndaj Laçit në "Elbasan Arena". Anësori 25-vjeçar shënoi golin e vetëm të takimit pasi një mori një asist perfekt nga Shafik në minutën e 60-të dhe në cilësitë e një numri 9 fals realizoi golin që i vlejti 3 pikë skuadrës verilindore. Mjaf domethënës edhe përqafimi mes futbollistëve, ku veçohet

Reginaldo, me trajnerin Armando Cungi, çka tregon që polemikat mediatike e javëve të fundit janë lënë pas. Kurbinasit, që një javë më parë mbanin rekordin e skuadrës së pamposhtur, tashmë janë kthyer me këmbë në tokë, por gjithsesi qëndrojnë në vend të katërt me 16 pikë, 1 më shumë se Teuta dhe Flamurtari. Për herë të parë në këtë sezon Luftëtari del nga zona e ftohtë e renditjes. Skuadra gjirokastripte mori një fitore me shumë peshë 0-2 në trans-

fertë me Kastriotin, një kundërshtar direkt për mbijetesën. Ekipi i drejtuar nga Gentian Mezani befasoi krutanët në fillim të pjesës së dytë me golin e Vasil Shkurtajt, pas krosimit të Rolovicit nga e djathta e sulmit dhe me golin e dytë të sulmuesit në minutën e 83-të. Luftëtari me këtë fitore parakalon Kamzën në renditje dhe barazohet me Tiranën në kuotën e 9-pikëve, ndërsa Kastrioti mbetet i fundit me 4 pikë dhe i shpëputur nga zona e mbijetesës.

SUPERLIGA

JAVA E 10-të

TE SHTUNEN
Kamza - Tirana 1-1
Flamurtari - Teuta 1-1

TE DIELEN
Kastrioti - Luftëtari 0-2
Laçi - Kukësi 0-1

TE HENEN
Partizani - Skënderbeu 19:00

RENDITJA

Skuadra	N	P
Partizani	9	22
Skënderbeu	9	20
Kukësi	10	19
Laçi	10	16
Teuta	10	15
Flamurtari	10	15
Tirana	10	9
Luftëtari	10	9
Kamza	10	8
Kastrioti	10	4

Sot kryendeshja Partizani-Skënderbeu

Shehi: Shkojmë për të fituar, nuk kemi presion për titullin

Trajneri i Skënderbeut, Orges Shehi ka dalë në konferencë pas heshtjes për shtyp të kësaj jave. Në prag të synon fitoren dhe se fakti që nuk kanë presion për fitimin e titullit, do t'i ndihmojnë shumë: "Ka qenë një javë e vështirë për ne, sa i përket dëmtimeve. Kemi tre lojtarë kryesorë që nuk janë stërvitur. Kemi dhe 24 orë deri në ndeshjen kundër Partizanit dhe shpresojmë t'i rikuperojmë të gjithë. Ne shohim skuadrën tonë, jo kundërshtarin. Shkojmë atje për të fituar. Në fushë duhet të japim gjithçka, e kam thënë që në fillimet e mia kur erdha këtu. Ne kurrsesi nuk kemi në presion për titullin, por kemi një skuadër që di të fitojë titullin. Në 8 vite kemi fituar 7 tituj dhe 11 trofe. Kjo skuadër e ka stofin e kampiones", përfundoi Shehi

Pa Mesin dhe pa Ronaldon, por "El Clasico" dhuron sërish spektakël dhe një rezultat 5-1



Jeton Selimi

Barcelona turpëron Realin, 5 gola dhe lavdi katalanase

Lopetegi i ka orët e numëruara, Konte dhe Solari në pritje

E dhe pa Leo Mesin e Kristiano Ronaldon, "El Clasico" mbetet një kryendeshje. Emocione, gola, spektatorë, tension, lojë e bukur dhe dëshpërim. Dëshpërimi është i Realit, i cili u mund 5-1, duke luajtur për keqardhje në pjesën e parë, që i shkoji fare pranë barazimit në fillimin e pjesës së dytë dhe që u shemb totalisht në fund të ndeshjes, i vënë përpara nga tregolëshi i Luis Suarezit. Lopetegi debutoi në klasike duke pësuar një "manita", e cila vetëm sa do të përshpejtojë shkarkimin e tij, që duket se është çështje orësh.

PRITJA
719 gazetarë të akredituar, 264 prej të cilëve të huaj nga 77 media të ndryshme. Një potencial prej 650 milionë spektatorësh në botë dhe 3.265 ata prezentë në "Camp Nou". Në radhë të parë ishte Tiago, djali i Mesit, që ashtu sikundër ndeshjen me Interin, shoqëroi babain e tij në stadium.

FORMACIONET
Barcelona zbrit në fushë po ata titullarë me të cilët mposhti Interin të mërkurën, me Rafinjën në vend të Mesit. Për Madridin, Izko luan pas Bejlit dhe Benzemasë, teksa qëndron sërish në stol Asensio. Naço luan mbrojtës i djathtë në vend të Karvahalit të dëmtuar, ndërsa Vinicuis, i preferuari i presidentit Perez, është sërish në tribunë.



FILLIMI
Nis me Barçën në sulm, tendencë kjo që nuk ndryshon ndonjëherë. Superioritet në mesfushë, rrezikshmëri ofensive, përqendrim dhe determinim. Gjithçka në favor të Barçës. Madridi është në ngërç, konfuz dhe i shpërbërë, ndaj e sheh veten në disavantazh pas 11 minutash: që nga fillimi katalanët sulmojnë pikën e dobët të Realit, krahun e djathtë të mbrojtur nga Naço. Rakitich bën të shpërthejë Zhordi Albën që gjen fundoren dhe pason në qendër për Kutinjon, që gjakftohët shënon golin e parë.

DYFISHIMI
Realit është edhe më shumë i trullësor kur pas gjysmë ore VAR-i i lejon gjyqtarit Sanchez Martinez të korrigjojë gabimin e tij fillestar dhe të vërshëllej një penallti të kotë të shkaktuar nga Varane nda Suarezit, me uruguajian që më pas mposhti Kurtuan. Për

Madridin pjesa e parë regjistroi vetëm disa gjuajtje nga jashtë zonës, por asnjë ide dhe vështirësi shumë të madhe përpara Barcelonës, që pati mundësi të tjera shënimi.

RILINDJA
Madridi e nisi pjesën e dytë me Lukas Vaskezin në vend të Varanes, që pati një problem muskolor. Spanjollji pozicionohet në krah, Naço del në qendër ku shkëmbehet me Kasemiron, që formon kështu një mbrojtje treshe me Ramosin. Madridi, që u pa i vdekur në pjesën e parë, u rigjallërua shpejt: zbritje në të djathtë e Izkos, krosim që Ter Shetegen nuk e ndal dot dhe Marcelo që shënon pasi ka mposhtur Piken. Braziliiani ka shënuar 3 nga 4 golat e fundit të Realit me të djathtën e tij.

DY SHTYLLAT
Dhe një çast pas rezultati 2-1, Modriç goditi shtyllën e Ter Shtegenit, që nuk mund të bënte asgjë. Barcelona që ishte si e trullësor, merr ngjyrë pas gati cerek ore, kur Suarez shënon me kokë vulos rezultatin 4-1. Në çastet e fundit të ndeshjes ka lavdi dhe Arturo Vidalin, që shërbehet në zonë nga Dembele dhe me kokë vulos rezultatin 5-1 për Barcelonën, që e mbyll kështu "tour de force" pasi pat mposhtur 4-2 Sevilljen dhe 2-0 Interin.

nga shtylla pasi u shërbye nga Sergi Roberto. Por sistemi i ri i lojës ka transformuar Madridin, që pati në kokën e Benzemasë mundësinë e radhës për të shënuar. Por gjuan jashtë dhe kush e di sa vetë në Madrid kanë guard ndërmend Kristiano Ronaldon...

SUAZES DHE "MANITA"
Dhe e merrni me mend sesa mbaroi ndeshja? Vetëm pak pas asaj çka shpërdoroi Benzema, kemi një krosim nga ana tjetër e fushës me Sergi Robertson që gjen kokën e Suarezit, me këtë të fundit që gjuan saktë nga 13 metrave larg portës. 3-1, por "El Pistolero" nuk ndalet këtu, kur shënon tregolëshin pasi përfitoi nga një gabim i Ramosit dhe me një lob perfekt kaloi Kurtuanë për rezultatin 4-1. Në çastet e fundit të ndeshjes ka lavdi dhe Arturo Vidalin, që shërbehet në zonë nga Dembele dhe me kokë vulos rezultatin 5-1 për Barcelonën, që e mbyll kështu "tour de force" pasi pat mposhtur 4-2 Sevilljen dhe 2-0 Interin.

Trajneri i Real Madrid, Zhuben Lopetegi, nuk ka ndër mend të japë dorëheqjen. Këtë ai e konfirmoi edhe sot në konferencën për shtyp pas ndeshjes së humbur kundër Barcelonës, ku përsëriti se pret me qetësi vendimin e klubit, por edhe se ka bindjen se mund të kthejë fatin e sezonit. "Një humbje është gjithmonë e vështirë, aq më shumë në shtëpinë e Barcelonës. Por kishim raste të pastra për të barazuar ndeshjen e për të



Të gjithë presin vendimin e tij, por...

Lopetegi: Nuk dorëhiqem, nuk jam unë përgjegjësi


ndryshuar fatin e saj. Në pjesën e parë kundërshtarët ishin më të mirë, por nuk ishte një pjesë lojë që duhej mbyllur 2-0. Në pjesën e dytë krijua raste dhe goditëm shtyllën. Nuk eci si duhej dhe në fund të ndeshjes erdhën dëmtime.

Goli i tretë na i shoi shpresat dhe rezultati përfundimtar është i ekzagjeruar. Kjo është një skuadër me probleme, por rezultati përfundimtar nuk reflekton realitetin e ndeshjes. Jam i trishtuar, si të gjithë në dhomat e zeshveshjeve, por

kam forca për të reaguar. Jam trajneri, jemi në tetor, është një goditje e rëndë, por kam forcë. Situata mund të përmbysët, pasi ka kohë dhe ne kemi cilësi. Na kanë prishur punë dëmtimet, ka lojtarë të tjerë, të cilët tani po vijnë në formë. Unë kam

forcë për të drejtuar ekipin, për këtë nuk kam asnjë dyshim. Nëse nuk kam dhënë dorëheqjen deri tani, atëherë mos e prisni. Unë thjesht dua të rris moralin e lojtarëve të mi. Edhe një herë nuk kemi marrë atë që meritoni. Kam besim të ky ekip e këta lojtarë. Në fund nuk jam unë që marr vendimet. Kam shpjeguar atë që mendoj dhe besimin që kam në këtë ekip. Pjesa tjetër nuk është përgjegjësia ime", tha Lopetegi para mediave.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Miller e Verdi-t.
- Më e mira është rektor.
- Inicialet e Derain.
- Kishte 100 Teba.
- Eshhtë vija e portës
- Në fund te rritjes.
- Drejtori Lokale Përmet.
- Inicialet e Seagal.
- King Cole i muzikes.
- Ishte shpendi simbol i Jezu Krishtit.
- Artikulli spanjoll.
- Janë fjalëpakë.
- Fillojnë titrat.
- Eshhtë i mërzitshmi.
- Ashtu si jeton heremiti.
- U kompozua nga Ravel.
- Janë spanjollët dhe portugezët.
- Një kitarë indiane.

- Janë edhe ato të sigurimit.
- Eshhtë e harlisur në xhungël.
- Mbyllin fushatat.
- Kështu thirrej Eisenhower.
- Ai dhe ajo.
- Fillojnë vallen.
- Inicialet e Delon.
- Kalohet në gjumë.
- Martini që që këngëtare
- Një thirrje me emra.

VERTIKAL

- U quajt qyteti atomik.
- Qyteti i Abrahamit.
- Italia në tabela.
- Sapo fillojnë.
- Nemo ai i Nautilus.
- Janë në botë
- Një tabu islamike
- I famshmi Pacino.
- Janë si falimentime
- Ngjyhet një në tavolocë.
- Timo i Mato Grudës.
- Janë borxhlinj.
- E përditshmja që ke në dorë.
- Carson i fumetti-t.
- U shkrua nga Sartre.
- Në fund të vitit.
- Eshhtë lloj poezie.
- Janë shtëpi... qeni.
- Janë kapriçiot.
- Verifikuar pjesërisht.
- Kërcimi i Fred Astaire.
- Eshhtë sekrete në derë.
- Kodi i celularit.
- Daja i Amerikës.
- Kaluar në krye.
- Fillojnë detyrën.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Atkinson, alias Mister Bean.
- Ishte dyqanxhi i dikurshëm.
- Ferrara regjisor.
- Kalohet në gjumë.
- Të parat në sondazh.
- Eshhtë nofka.
- Një treshe në skenë.
- Nuk i tregohen babait.
- Gjysmë tatimi.
- Berenger aktor.
- Në mes të një forme.
- Bëjnë stil të lirë
- Fillojnë nazet
- Kalimi në kufij.
- Një tragjedi... e Dreiser.
- Grier aktore.
- Dashi kur mungon ai
- Eshhtë zanore në filma
- Kufizohet në kufij
- Ente Civile Europiane.

VERTIKAL


- Eshhtë edhe ajo emërore.
- Eshhtë edhe ai mbretëror.
- Të parat në Wellington
- Një vegël
- Eshhtë vendi aderues
- Eshhtë emirat.
- Mbyllin portat.
- Pak latinisht.
- Janë zjarrvënës.
- Qyteti i perjetshëm.
- Kufizojnë rastet.
- Shkroi Këngëtarja tullce.
- Inicialet e Moravia-s.
- Janë trille.
- Qytet italian.
- Jepen për hartim.
- Fillojë takimet.
- Kufizojnë kënde.
- Janë vendet e para.
- Një greminë.
- Eshhtë hlogarinq që qërohet.
- Ndëqen me ilaçe.
- Massari aktore italiane.
- Janë kapot.
- Numi i oktetit.
- Kush ka... fërgëllon.
- Një i fundit mbi të gjithë.
- Një pjesë e satelitëve.
- Fillojnë tjetrën.
- Derisa janë në fund.
- Inicialet e Taylor aktore.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

8	4		1	5	2			
9				6	1	4	7	
			2					
3	1		9	4	2		5	
		8					9	
4	5		6					
	8					7		
6			3	7		1		
7	3	2	1		4			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	3	5	1	8	2	6	7	4
6	7	1	3	4	9	8	5	2
4	2	8	6	5	7	9	1	3
5	4	9	2	3	8	7	6	1
2	1	7	4	6	5	3	8	9
8	6	3	9	7	1	2	4	5
7	8	4	5	9	3	1	2	6
3	5	2	7	1	6	4	9	8
1	9	6	8	2	4	5	3	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Librat janë për njerëzit që urojnë të ishin diku tjetër (Mark Twain)
- Gjithkush dëshiron të jetojë në kurriz të shtetit. Ata harrojnë se shteti jeton në kurriz të të gjithëve (Frederic Bastiat)
- Mos qaj për të shkuarën, mos endëro për të ardhmen, përqendro mendjen tek e tashmja (Buda)
- Mos i bëj të tjerëve atë që s'të pëlqen të ta bëjnë ty (Sokrati)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

S	H	I	A		12	7	7	8	6	11		
1	4	3	8		10	1	14	5		1	8	
18	1	8		5	3	9	3	8	2	12	2	
2	8		5	6	4	6	9	1	9	2	8	
8		12	1	15	2	8	1	11	2	7	8	3
6	1	11	12	9	1			8		9	11	
9	3	1	2	6	7	16	2	1	3			
3	7		4	1	8	6		8	2	14		
13	1	7	7		15	6	3	11		4	6	
4	2	12	2		8		11		13	3	17	
1	4	3	7	8	3	20	2	7	6		8	1
8	1			18	1	9	1	12	1		2	8

- Mendoj, pra jam (René Descartes)
- Vdekja s'duhet të na shqetësojë pasi kur ne ekzistojmë vdekja nuk ekziston, dhe kur vdekja ekziston, ne s'do të jemi më (Epikuri)

- Jeto sikur do vdesësh nesër, mëso sikur të duhet të jetosh gjithmonë (Mahatma Gandhi)
- Bëj punën që do, dhe nuk do të të duhet të punosh kurrë (Konfucij)

Thënie të mënçura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	T	A		H	E	L	M	E	T			
A	R	R	V	E	D	E	P	P		P			
P	A	R	A	L	E	L	E	T		L	E	R	
			P	O	L	I	F	E	M	I	O	L	E
E	M	I	L	E	Z	O	L	A	E	T	I	K	
L	A	I	R	A	E		R	R	E	Z	E		
E	R	A	I	B	E	M	R	I	I	S			
H	T	M	A	E	S	T	R	O	D	E			
T	A	L	E	N	T	E	T	A	R	T	E		
E	S	K	R	A	H	O	R	A	T	A	T	E	
K	A	P	A	N	O	N	E	T	L	A	L	A	
D	I	S	K	O	T	E	K	A	T	A	P		
R	O	M	A	N	A	R	G	O	S	A			
E	N	T	G	N	T	R	H	A					
W	M	O	N	O	G	R	A	F	I	A	A		
P	E	L	E	G	R	I	N	A	Z	H	E	T	
P	O	L	I	G	L	O	T	E	T	D	E		
A	I	L	K	R	A	H	E	T	K	S	H		
K	E	N	I	T	T	K	A	T	E	T			
E	M	I	L	E	E	N	J	O	M	E	R		
T	I	M	E	R	S	T	A	N	E	T	I		
A	K	S	E	R	I	O	Z	A	R	A	M		
T	E	O	T	R	A	Z	J	A	R	R	I		

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

